


Dr. Musli Vërbani

NATA E DHËNDËRISË



Kaçanik, 2005





Autori:
Dr. Musli VËRBANI

Titulli:
NATA E DHËNDËRISË



Korrektura:
Daut Shehu

*Radhitja kompjuterike,
kopertina dhe dizajni grafik*
Mumin Shehu

**Prishtinë
2005**

Të drejtën e ribotimit e rezervon botuesi





وَأَنْكِحُوا الْأَيَامَىٰ مِنْكُمْ وَالصَّالِحِينَ مِنْ عِبَادِكُمْ وَإِمَائِكُمْ إِنْ
يَكُونُوا فُقَرَاءَ يُغْنِهِمُ اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ وَاللَّهُ وَاسِعٌ عَلِيمٌ

**"MARTOHUNI ME TË PAMARTUARAT
DHE MARTOHUNI ME TË
PAMARTUARIT NGA MESI JUAJ
DHE ROBËRIT TUAJ E ROBËRESHAT
TUAJA QË JANË TË SINQERTË.
NËSE JANË TË VARFËR, ALLAHU DO
T'U JAPË NGA BEGATIA E VET ...".**

(EN-NUR, 32)

**وَالطَّيِّبَاتُ لِلطَّيِّبِينَ وَالطَّيِّبُونَ لِلطَّيِّبَاتِ
"... TË MIRAT PËR TË MIRËT,
TË MIRËT PËR TË MIRAT ...".**

(EN-NUR, 26)





NË VEND TË PARATHËNIES



الحمد لله رب العالمين و الصلاة والسلام على رسولنا محمد و على آله
و صحبه اجمعين.

Lexues të nderuar, posaçërisht ju të rinj, ky libër ju kushtohet juve të cilët jeni ardhmëria, ju të cilët jeni prespektiva dhe ju të cilët do të krijoni familje dhe do të bëheni prindër. Në rend të parë luteni Zotin e Madhëruar me këtë dua:

... رَبَّنَا هَبْ لَنَا مِنْ أَزْوَاجِنَا وَذُرِّيَّاتِنَا قُرَّةَ أَعْيُنٍ

وَاجْعَلْنَا لِلْمُتَّقِينَ إِمَامًا

"O Zoti ynë: na dhuro bashkëshort (bashkëshorte) dhe pasardhës të cilët, na bëjnë të lumtur, na gëzojnë, na qetësojnë trupin e shpirtin dhe na pushojnë sytë në ta. E, po ashtu, na bën shembull për të devotshmit".

EL FURKAN, 74

Kush prej jushe të rinjve ka aftësi fizike dhe mundësi materiale për të siguruar ushqim, veshmbathje dhe vendstrehim, le të martohet, e kush nuk ka mundësi, le të agjërojë sepse agjërimi është preventiva më e mirë për ta sunduar epshin (deri sa të vijë koha të martoheni dhe të hyni dhëndër dhe të filloni një jetë krejt të re, jetë të re me kënaqësi dhe vështirësi, lumturi dhe përgjegjësi, jetë me qetësim trupor, psikik dhe me angazhim fizik, jetë me qetësim shpirtëror dhe brenga jetësore). Deri sa të arrish në atë fazë të jetës, e ke për obligim që për martesë të hulumtosh një bashkëshorte të mirë, ndërsa bashkëshortja më e mirë është ajo që është me fe dhe edukatë. Le të mos jetë preokupim kryesor në këtë hulumtim gruaja e pasur, apo nga ndonjë familje e madhe dhe e njohur, apo që ka bukuri të papërshekruar. Jo, këto nuk janë gjërat kryesore të një bashkëshorte të mirë, por para së gjithash hulumto për një bashkëshorte që ka besim të fortë. Nuk ka dobi



prej bashkëshortes me iman të dobët dhe me edukatë të keqe. Këshilltari i njerëzimit Muhamedi a.s. ka thënë:

"Me gruan lidhet kurorë për katër gjëra: për pasurinë, për fisin, për bukurinë dhe për besimin. Ti hulumto, shiko dhe martohu me atë që është besimtare dhe do të fitosh qetësi dhe lumturi në jetë, në të kundërtën do të jesh i mbështetur për tokë".

BUHARIU DHE MUSLIMI

Bëne preokupim kryesor gruan e mirë dhe fetare, atë që ta bën jetën xhenet dhe të bën t'i frikësohesh Allahut, atë që t'i plotëson të gjitha të drejtat dhe detyrat, që ta mbron nderin dhe pasurinë, që t'i siguron dhe edukon fëmijët, që ta mbron identitetin dhe sekretet tua.

Hulumto për një grua që është besimtare, e moralshme dhe e edukuar. Nuk është e ndaluar që të hulumtosh për një bukuroshe. Përkundrazi, është e domosdoshme të jetë e bukur, që kur ta shikosh të pushojnë sytë, të gëzohesh dhe të qetësohet shpirti. Por, bukuria është diç relative. Ti ndoshta e sheh të bukur, por dikush tjetër nuk e sheh të tillë. Për këtë arsye islami obligon që të dy palët, të cilët dëshirojnë jetë të përbashkët, të shihen mes vete, që edhe i fejuari ta shohë të fejuarën, por edhe e fejuara ta shohë të fejuarin, sepse syri është i deleguari i mendjes dhe i zemrës. Njeriu, që në shikim të parë mund të hetojë diçka në zemrën e vet, qoftë pozitive, qoftë negative.

Prind i nderuar, edhe ju obligoheni që t'i zgjedhni vajzës suaj bashkshort nga më të mirët, dhe të mos jetë prej atyre të cilëve u intereson pasuria, prejardhja, pozita shoqërore, ndërsa nuk është i moralshëm, besnik dhe besimtarë i sinqertë. I dërguari i Allahut s.a.v.s. thotë:

"Kur t'u vijë ndonjëri që është fetar i denjë dhe i moralshëm për të kërkuar bijën tuaj, martojeni me atë, se për ndryshe do të ketë ngatërresa, probleme e shkatërrime në përmasa të mëdha".





Feja, besnikëria, dhe edukata e mirë paraqesin kriterin e vërtetë të bashkëshortit të ardhshëm, sepse njeriu vlerësohet sipas fesë, edukatës dhe moralit. A thua, çfarë vlere ka njeriu i cili ka pasuri të shumtë, por në të njejtën kohë është pijanec dhe i shëmtuar, nuk është i sjellshëm, është i pa edukuar, jo besnik, pa ndërgjegjje dhe i pashpirt. Bashkëshorti i tillë nuk sjell as lumturi, as gëzim, as qetësi dhe as kënaqësi.



Nëse bijës i zgjedhni një person i cili është fetar i denjë, nëse e do, do ta nderojë dhe do ta respektojë atë, e nëse e urren nuk i bën padrejtësi.

Lexues të nderuar, posaçërisht ju të reja dhe të pamartuara, fjalën përfundimtare dhe vendimtare për të lidhur kurorën e keni ju. Kuptohet, për këtë të nevojitet edhe ndihma, të nevojiten këshillat dhe përkrahjet. Edhe ju duhet të hulumtoni dhe ta zgjedhni bashkëshortin, sepse islami femrës ia ka lënë jetën e lirë, ajo ka të drejtë të zgjedhë sipas dëshirës bashkëshort (burrë), ta pranojë apo ta refuzojë, të posedojë pasuri të të gjitha llojeve, si dhe vetë të komandojë.

Pasi që martesë bën pjesë në vendimet më të rëndësishme dhe më serioze të jetës sate, gjatë zgjedhjes së bashkëshortit duhet shikuar mirë të gjithë rrethanat, e pastaj të vendosësh se me kë do të hysh në jetë të përbashkët. Konsultohu me ata të cilëve u beson në mendime, që e kryejnë amanetin dhe kanë fe. Shiko lexuese e nderuar se si Fatime Bint Kajsi kur është konsultuar me të dërguarin e Allahut (s.a.v.s.) për martesë, kur e kishin kërkuar dy nga shokët e pejgamberit s.a.v.s., njëri ishte Muavije Iben Ebi Sufjan, kurse tjetri Ebu Xhehm, i dërguari i Allahut s.a.v.s. i ka thënë:

"Për sa i përket Muavijes, ai është i varfër, nuk ka pasuri dhe nuk posedon dot gjë, pasurinë e ka të babait, ndërkaq, Ebu Xhehmi është njeri i cili asnjëherë nuk e lëshon shkopin nga krahërori". Fatime Bint Kajsi nuk u martua me asnjërin prej tyre, por u martua me Usame Bin Zejdin".





I dërguari i Allahut s.a.v.s. e ka refuzuar dhe nuk e ka lejuar martesën e një vajze nga Ensarët, e quajtur Hansa Bint Hadad, të cilën dëshironin ta martonin pa pëlqimin e saj. Po ashtu i dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

"Nuk ka martesë pa vendimin e gruas së ve dhe pa lejen e vajzës. Leja e vajzës është heshtja e saj".



Pasi të vështrosh, të analizosh të gjitha rrethanat dhe para marrjes së vendimit bëne këtë dua:

O Zoti im! Ti di e unë nuk di, Ti cakton e unë nuk mund të caktoj. Ti i di çshtjet e fshehta. Nëse e sheh se filani (ia thua emrin) sjell dobi dhe të mira në jetën time, në fenë time, dhe në botën tjetër për mua, cakto që të jetë (bashkëshort) për mua, ndërsa nëse ndonjë tjetër është më i mirë dhe sjell më shumë të mira në fenë time, jetën time dhe në botën tjetër për mua caktoje atë (të jetë bashkëshorti im)".

Martesa është një prej çështjeve më të rëndësishme të njeriut, andaj gjatë zgjedhjes së shokut bashkëshortor duhet shikuar të gjitha rrethanat, dhe pasi që i riu apo e pamartuara të vendosë me cilën të fillojë jetën bashkëshortore, mirë është që të kërkojë ndihmë nga Allahu, t'i ndihmojë ta marrë vendimin definitiv. Transmetohet se pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Para se të fejojesh, mbaje nijetin tënd të fshehtë dhe qëllimin e fejesës së fshehtë, pastaj merr abdest, plotësoje abdestin mirë, pastaj fal namaz (dy rekate), pastaj falënderoj Allahun, lavdëroje atë dhe thuaj: O Zoti im! Ti di, e unë nuk di, Ti cakton e unë nuk mund të caktoj. Ti i di çështjet e fshehta. Nëse e sheh se filanja (ia thua emrin) sjell dobi dhe të mira në jetën time, në fenë time, dhe në botën tjetër për mua, cakto që të jetë (bashkëshorte) për mua, ndërsa nëse ndonjë tjetër është më e mirë dhe sjell më shumë të mira në fenë time, jetën time dhe në botën tjetër për mua, caktoje atë (të jetë bashkëshortja ime)".

(AHMEDI, IBN HABANI, HAKEMI E TË TJERË)



Lexues dhe lexuese të nderuara: Martesa është burimi më i pasur i kënaqësisë jetësore, por me kusht që ajo në të gjitha komponentat e veta të realizohet plotësisht. Për të ekzistuar një martesë e lumtur dhe e vlefshme, nevojitet angazhim i madh nga të dy bashkëshortët, sepse martesa kërkon shumë, por edhe jep shumë. Bashkëshortësia e suksesshme është si vepra artistike, të cilës njeriu plotësisht duhet t'i përkushtohet.

Martesa është obligim fetar, ruajtës i moralit dhe besëlidhje shoqërore. Si obligim fetar, ai duhet të plotësohet sikurse edhe të gjitha obligimet tjera të fesë islame. Këtë mund ta kryejnë, ta përjetojnë dhe ta gëzojnë vetëm ata që janë të aftë të ballafaqohen me përgjegjësitë dhe obligimet që rezultojnë nga vetë martesa. Martesa është një besëlidhje e fortë në mes bashkëshortëve dhe në mes të bashkëshortëve dhe Zotit. Në këtë besëlidhje plotësohet vetëkuptimi reciprok, dashuria, urtësia, paqa, mëshira dhe lumturia.

Për një jetë të lumtur bashkëshortore është karakteristikë ndjeshmëria reciproke. Do të thotë: bashkëshortët përherë duhet të jenë të gatshëm që njëri-tjetrit t'ia plotësojnë dëshirën, ta gazmojnë ose ta ngushëllojnë njëri-tjetrin, ta trimërojnë dhe ta lavdërojnë, ta kuptojnë, të jetojnë me nevojat, interesat dhe aktivitetet, me brengat dhe vështirësitë, të ndihmojnë dhe t'i ofrojnë përkrahje emocionale njëri tjetrit. Bashkëshortët e mirë, për të krijuar jetë të lumtur, i përshtaten njëri-tjetrit.

Jeta bashkëshortore është themel i familjes, e familja është themel i shoqërisë. Sa më shumë bashkëshortësi të lumtura dhe të harmonizuara, aq më pak probleme dhe brenga për tërë shoqërinë. Dashuria dhe harmonia bashkëshortore sigurojnë lumturinë e vërtetë. Kjo harmoni e bën jetën "Xhenet të kësaj bote", në të cilën fitohet edhe "Xheneti i botës tjetër".





AKTI I KURORËZIMIT

Akti i kurorëzimit është i papranueshëm deri sa të mos plotësohen kushtet, si oferta dhe pranimi i ofertës, pra pëlqimi i dy të kurorëzuarve, dhe pa prezentimin e dy dëshmitarëve, të cilët dëshmojnë fuqizimin e aktit të kurorëzimit. Gjatë fuqizimit të aktit të kurorëzimit është vaxhib caktimi, respektivisht dhurimi i mehrit prej dhëndërit. Kjo argumentohet me ajetin Kur'anor:

وَأَتُوا النِّسَاءَ صَدُقَاتِهِنَّ نِحْلَةً

"Grave jepni dhuratën e kurorës së tyre (MEHRIN) më të mirë".

EN-NISA 4


Zakonisht akti i kurorëzimit, me fjalë tjera kontrata e martesës, hartohet apo përpilohet prej Kadisë (gjyqtarit islam), mirëpo në mungesë të tij këtë e kryen imami, gjegjësisht kryeimami, pastaj nënshkruhet martesa përmes shkëmbimit të pëlqimeve para dëshmitarëve.

Prindi (ose vekili) i vajzës thotë:

Në emër të Allahut, i mbështetem Allahut, kërkoj mbrojtje dhe siguri prej Allahut vajzën time ----- e kam dhënë (martuar) për ty, dhe atë sipas traditës së të dërguarit të Allahut me mehrin e caktuar në vlerë prej ----- . Këtë e bëjnë para dëshmitarëve të pranishëm, ndërsa dëshmitari më i mirë është Allahu.

Pastaj dhëndri thotë:

Në emër të Allahut, i mbështetem Allahut, kërkoj mbrojtje dhe siguri prej Allahut, e kam pranuar martesën me filanen dhe atë sipas traditës së të dërguarit të Allahut me mehrin e caktuar në vlerë prej ----- . Këtë e bëj para dëshmitarëve të pranishëm, ndërsa dëshmitari më i mirë është Allahu.



Siç shihet, pastërtia morale, ngritja shpirtërore, intergriteti social, stabiliteti njerëzor, paqja dhe mëshira janë elemente kryesore të aktit të kurorëzimit. Ky akt në të vërtetë është një kontratë për të cilën vet Zoti është dëshmitari i parë dhe pala e parë. Kjo kontratë shkruhet me emrin e Tij në dëgjueshmërin e Tij, në pajtim me urdhëresat e Tij. Kjo është një shoqërueshmëri e rregullt njerëzore që organizohet dhe mbikëqyret nga Zoti. Nga kjo shihet qartë se martesë është një mjet i marrëdhënieve permanente dhe i një harmonie të vazhdueshme, jo vetëm ndërmjet burrit dhe gruas, por edhe ndërmjet tyre dhe Zotit, që do të thotë se besëlidhja e fortë e tyre të jetë edhe për kohëra të mira edhe aso të vështira. **Pastaj bëhet duaja:**

Në emër të Allahut dhe sipas traditës së të dërguarit të Allahut O Zoti ynë bëne këtë akt të fatshëm dhe të bereqetshëm, martesën e tyre të harmonishme, të dashur e vetëqetësim për ta, e mos bën në mes tyre ndarje e pakënaqësi.

Zoti ynë bashkoj këta dy siç e bashkove Ademin e Havanë, Muhamedin a.s. e Hatixhën, Aliun e Fatimën.

Zoti ynë, jepi çfittit të ri fëmijë të mirë, jetë të gjatë dhe furnizim të begatshëm.

Zoti ynë, na bër që të jemi të gëzuar me punët e grave tona dhe pasardhësve tanë, e neve na bën shembull për të devotshmit.


Zoti ynë na jep të mira në këtë jetë dhe në botën tjetër dhe na ruaj nga zjarri i xhehenemit.


O Zoti ynë na bën neve nga ata që falin namazin edhe pasardhësit tanë dhe pranoj lutjet tona.

Zoti ynë na fal gabimet tona, të prindërve tanë, fali edhe të gjithë besimtarët ditën kur jepet llogaria.

I pastër e i lartë është Zoti ynë, Zot i Gjithëfuqishëm nga ajo që ata i përshkruajnë. Çdo e mirë qoftë ndaj të Dërguarve.

Dhe falenderimi i qoftë Allahut, Zotit të gjithësisë. (el-fatihah)





Pas aktit të kurorëzimit mirë është të mbahet një fjalim apo hutbe. Hutbeja kryesisht duhet të përqëndrohet në këto ajete:

"El-hamdu lil-lah. Nahmeduhu ve nesteinuhu ve nestegfiruhu ve nestehdih. Ve neudhu bil-lahi min shururi enfusina ve min sejjiati eamalina. Men jehdil-lahu fela mudil-le leh ve men judlil fela hadije leh.

Ja ejjuhel-ledhine amenu ittekull-llahe hakka tukatihi ve la temutunne il-la ve entum muslimunë.

Ja ejjuhel-ledhine amenu ittekull-llahe ve kulu kavlen sedida. Juslih lekum eamalekum ve jegfir lekum dhunubekum. Ve men juti'il-lahe ve resulehu fe kad faze feuzen adhima".

Në disa vende, 3 ditë para ditës së kurorëzimit, kur dërgohen rrobat dhe përgatitjet tjera (Qezi) në dëshminë e të dy palëve caktohet mehri. Në disa raste bëhet një ditë para dasmës, në disa vende atë ditë kur shkojnë krushqit apo ditën e martesës.

Ka filluar një traditë, ku bashkëshortët e bëjnë aktin e kurorëzimit dhe kalon një kohë e gjatë dhe nuk e bëjnë dasmën, apo ceremoninë e martesës, kështu që ata në atë interval kohor vetëm takohen në rrugë, shëtiten dhe ulen në vende publike, ndërsa të tjerët mendojnë se ata e kanë të ndaluar kontaktin martesorë, sepse ende nuk kanë bërë dasmën. Në anën tjetër, bashkëshortët hapin dyert e thashethënieve. Për këtë arsye duhet të jetë e qartë: pas plotësimit të kushteve edhe ruknit të martesës (dy dëshmitarëve dhe pëlqimit bashkëshortor) bashkëshortët e kanë të lejuar kontaktin martesor.





TË NGATËRRUARIT E AKTIT TË KURORËZIMIT ME AKTIN E FEJESËS

Fejesa është përgatitje për kurorëzim. Është e pëlqyeshme që ajo (fejesa) të bëhet para kurorëzimit, edhe pse në fakt mund të bëhet kurorëzimi edhe pa fejesë. Edhe pse për këtë çështje duhet shpjeguar më shumë do të përqëndrohemi në gabimet, apo me traditat të cilat bëhen me rastin e fejesës dhe martesës (myzhdës dhe dasmës).



Në fakt, tek ne, fejesa (myzhdja) dhe martesë (dasma) nuk dallojnë njëra me tjetrën në aspekt edhe të ceremonive, edhe të veprimeve, edhe të rregullave. Kjo është traditë e gabuar. Dalloni vetëm pse në fejesë (myzhde) nusja nuk shkon në shtëpi të dhëndërit. Ndoshta dikush mund të thotë se në fejesë (myzhde) ceremonia bëhet më e vogël, shpenzimet më të vogla se sa në ceremoninë e dasmës. Mirëpo, ne nuk po diskutojmë për këtë sepse, ceremonia është një, pa marr parasysh a është e vogël apo e madhe. Po ashtu, edhe rregulli apo veprimi i aktit të fejesës dhe i aktit të kurorëzimit është pothuajse i njëjtë. Dallimi tek ne është vetëm në atë se në fejesë (myzhde) krushqit e të fejuarës nuk e marrin dhëndërin me vete prej shtëpisë së tij për ta dërguar në shtëpinë e të fejuarës, ndërsa në dasmë krushqit e marrin nusen me vete dhe e dërgojnë në shtëpinë e dhëndërit.

Gabimet, të cilat bëhen me rastin e fejesës (të cilat janë traditë), që duhet përmirësuar janë këto:

E para: Në fejesë, dy ditë apo tri ditë këndohet pa ndërprerë dhe proklamohet shumë gjë që në islam fejesa nuk është mirë të proklamohet shumë, ndërsa martesë po, sepse Muhamedi a.s. ka thënë:

"Proklamone martesën duke përdorë edhe defin".

Pra, këtu është në pyetje martesë, e jo fejesë. Fejesa nuk është mirë të proklamohet shumë, sepse është akt jo i domosdoshëm,



vetëm premtim për martesë. Po ashtu, edhe gostia e cila bëhet me rastin e fejesës (myzhdes).

E dyta: Në fejesë (myzhde) i autorizuari i të fejuarës (vekili) nuk caktohet babai i saj, as vëllai më i madh i saj (në mungesë të babës), por zakonisht daja apo dikush tjetër. Sipas sheriatit islam në hirearkinë e trashëgimisë në rend të parë është babai, pastaj vëllai etj.

Edhe në autorizimin e dhënies së dorës (fejesës) duhet shkuar në të njëjtën mënyrë. Mirëpo, tek ne prindi nuk shkon fare (duke menduar se është turp ta japë dorën e vajzës), por shkon njëri apo dy prej vëllezërve por edhe ata nuk e japin dorën??? Kjo nuk është në rregull, sepse ata kanë përparësi në falje të gjakut etj., të cilat janë të njohura në sheriatin islam, e ajo përparësi duhet të jetë edhe në dhënie të dorës.

Vekili i femrës së fejuar në rend të parë duhet të jetë babai. Nëse ai mungon, atëherë vallau më i madhi, e kështu me radhë, ndërsa në mungesë të tyre (kur nuk i ka fare) atëherë vekilin e cakton vet e fejuara. Por, edhe dorën e fejesës edhe teslimin e martesës në rend të parë duhet ta bëj babai, në mungesë të tij - vëllau i madh e kështu me radhë.

E treta: Forma e kontratës apo teksti i dhënies së dorës, pasi ngriten në këmbë, zakonisht daja i të fejuarës, mixha apo dikush tjetër del para babait të të fejuarit (shkon te i fejuari baba e jo vet i fejuari i cili është prezent në dhomë???) dhe i thotë: citoj: Në emër të Allahut, sipas traditës së të dërguarit të Allahut, a është e vërtetë se filani, i biri i filanit e ka kërkuar filanen, vajzën e filanit për djalë.

- Përgjigjet: Po, e vërtetë është.
- Atëherë filani ta ka dhanë vajzën për djalë.

Vërejtje: I tërë ky formulim, duke ia bashkangjitur edhe ceremoninë e fejesës (myzhdes) edhe prezenca e të afërmeve (ku zakonisht janë dy-tri sofrë) nuk është fejesë, myzhde por në esencë është vetëm akt kurorëzimi.



Por nëse në prezencën e të afërmëve, gostisë, formulimi i tekstit bëhet "***Ka pranuar ta fejojë vajzën e tij për djalin tënd***" Kjo është në rregull dhe është fejesë.

Dallimi në mes të fejesës dhe aktit të kurorëzimit duhet të jetë që fejesa të jetë "***për kohën e ardhshme***", ndërsa akti i kurorëzimit "***për kohën e kaluar***". Ndoshta mund të thuhet se me rëndësi është qëllimi i folësit, e jo fjala e tij. Por, duhet pasur parasysh se Rukn (farz) i aktit të kurorëzimit është oferta (ixhabi) dhe pranimi (Kabuli).

Dijetarët janë pajtuar që oferta (ixhabi) mund të jetë për kohën e ardhshme "***A pranon***", "***A e marton***", "***A e jep***". Ndërsa pranimi (Kabuli) pa tjetër duhet të jetë "Në kohën e kaluar" se për ndryshe akti nuk vlen psh. "***E ka dhënë***", "***E ka martuar***".



CAKTIMI I DITËS SË MARTESËS

Fjala "**NIKAH**" (Martesë) në gjuhën arabe ka dy kuptime:

E para: Akti i kurorëzimit

E dyta: Marrëdhëniet seksuale bashkëshortore.

Sa i përket "**NIKAHIT**" apo aktit të kurorëzimit me fjalë të tjera ditës së martesës, lejohet të caktohet çdo ditë, çdo javë dhe çdo muaj të vitit bile, edhe gjat muajit ramazan. Ndërkaq, sa i përket marrëdhënieve seksuale bashkëshortore, kjo gjë nuk lejohet vetëm gjatë ditës, prej agimit e deri në aksham. Ndërsa nëse martesë bëhet ditën, ndërsa dhëndëria natën, është e lejuar, sepse Zoti i Madhëruar në Kur'anin fisnik thotë:


أَحِلَّ لَكُمْ لَيْلَةَ الصِّيَامِ الرَّفَثُ إِلَى نِسَائِكُمْ هُنَّ لِبَاسٌ لَكُمْ وَأَنْتُمْ لِبَاسٌ لَهُنَّ
عَلِمَ اللَّهُ أَنَّكُمْ كُنْتُمْ تَخْتَانُونَ أَنْفُسَكُمْ فَتَابَ عَلَيْكُمْ وَعَفَا عَنْكُمْ فَالآنَ
بَاشِرُوهُنَّ وَابْتَغُوا مَا كَتَبَ اللَّهُ لَكُمْ وَكُلُوا وَاشْرَبُوا حَتَّى يَبَيِّنَ لَكُمْ الْخَيْطُ
الْأَبْيَضُ مِنَ الْخَيْطِ الْأَسْوَدِ مِنَ الْفَجْرِ

"Natën e agjërimit u është lejuar afrimi (kontakti martesor) te gratë tuaja. Ata janë krijuar si një mbulojë (veshje). E edhe ju jeni si një mbulojë për to. Allahu e di se ju e keni mashtruar vetveten, andaj ua pranoi pendimin, e ua fali gabimin. Tash e tutje kontaktoni dhe kërkoni atë që ua ka caktuar Allahu dhe hani e pini deri sa të dallohet peri i bardhë nga peri i zi në agim".

EL BEKARE, 187

Nëse dasma bëhet në ramazan ditën dhe dhëndëri ditën kontakton intimisht me bashkëshorten, atëherë dënimi për bashkëshortët është që secili prej tyre:

- ose të lirojnë nga një rob
- ose t'i ushqejnë nga 60 të varfër
- ose t'i agjërojnë nga 60 ditë



Transmetohet në hadithë se:

“Shkon një njeri te Muhamedi a.s. e i thotë:

- ***Jam shkatërruar, o i dërguar i Allahut.***
- ***Po si je shkatërruar? – e pyeti i dërguari a.s.***
- ***Kam kontaktuar me gruan ditën e ramazanit (dhe e kam prishur atë ditë).***
- ***A ke rob të lirosh – i thotë Muhamedi a.s.***
- ***Jo, nuk kam.***
- ***A ke mundësi t'i agjërosh dy muaj rreshtazi?***
- ***Jo!***
- ***A ke mundësi t'i ushqesh gjashtëdhjetë të varfër?***
- ***Jo!***

Po ashtu, sa i përket haxhiut, i cili është duke e kryer haxhin dhe është në Meke, gjatë kohës, deri sa ai është në ihram, lejohet të bëjë aktin e kurorëzimit, ndërsa i ka të ndaluar vetëm marrëdhëniet bashkëshortore. Ndërsa pasi të lirohet prej ihramit, pa marr parasysh prej ihramit të haxhit apo të umres, lejohet të kryejë marrëdhënie seksuale bashkëshortore.

Zoti i Madhëruar në kur'anin fisnik thotë:

الْحَجُّ أَشْهُرٌ مَّعْلُومَاتٌ فَمَنْ فَرَضَ فِيهِنَّ الْحَجَّ فَلَا رَفَثَ


"E kush e bën haxhin (është në zbatim të kryerjes) në këtë muaj, nuk ka të drejtë të kontaktoj intimisht me bashkëshorten".

EL BEKARE, 197

Duhet theksuar se ai i cili nuk është në ihram, pra nuk është duke e kryer haxhin lejohet që të martohet edhe në kohën (pra në ditën) e Kurban Bajramit, edhe para Kurban Bajramit, edhe pas Kurban Bajramit. Lejohet martesë edhe gjatë ditëve të Fitër Bajramit, edhe para Fitër Bajramit, edhe pas Fitër Bajramit.

Transmeton Buhariu nga Ibn Abasi se i dërguari i Allahut s.a.v.s. është martuar apo e ka bërë aktin e kurorëzimit deri sa ka qenë në ihram në haxh.





Nëse akti i kurorëzimit bëhet deri sa haxhiu është në ihram dhe kontakton intimisht me bashkëshorten e posa kurorëzuar para qëndrimit në Arafat, haxhi zhvlerësohet dhe nevojitet vitin tjetër të shkojë haxh.

Nëse akti i kurorëzimit bëhet deri sa haxhiu është me ihram dhe kontakton intimisht me bashkëshorten e posakurorëzuar pas qëndrimit në Arafat haxhi pranohet, por vaxhib e ka të presë një deve kurban.

Një pjesë e fukahave thonë se Muhamedi a.s. e ka bërë aktin e kurorëzimit pasi që është liruar prej haxhit. Sido që të jetë Muhamedi a.s. e ka bërë aktin e kurorëzimit në ihram deri sa ka qenë në haxh, ndërsa pasi është liruar prej ihramit e ka vazhduar jetën bashkëshortore.

Është e ndaluar, siç ka filluar të bëhet traditë jo islame, që bashkëshortët, në vend publik apo në masë e shtrojnë tryezën dhe e vendosin tortën, pastaj tortën e prejnë së bashku. Në fillim i japin njëri-tjetrit, e pastaj fillon edhe masa ta hajë atë tortë (ëmbëlsirë), me qëllim që jeta e tyre bashkëshortore të jetë e lumtur dhe e ëmbël. Mirëpo, kjo është në kundërshtim me shariatin islam .

Kjo do të thotë në vend të ilaqit për shërim të bësh helmim për shërim. E helmi nuk shëron por vetëm helmon. Po të vendosej një tortë (ëmbëlsirë) në dhomën e dhëndërisë dhe t'ia jepnin njëri-tjetrit, kjo do të ishte e mirë dhe e pëlqyeshme. Marëdhëniet seksuale bashkëshortore nuk lejohen gjatë kohës së menstruacionit.

Kur të caktohet dita e martesës, duhet pasur parasysh që femra mos të jetë në kohën periodike të menstruacionit. Nëse është në kohën e menstruacionit, pritet koha e ndërprerjes së menstruacionit. Minimumi i kohës së menstruacionit është tri ditë e tri net, maksimumi dhjetë ditë e dhjetë net.

Nëse ndodh që femrës në ditën apo një ditë para nusërisë i vijnë menstruacionet, atëherë dhëndëri e ka të ndaluar të kryejë marrdhënie intime. Ai patjetër duhet të presë





deri sa t'i kalojë menstruacioni. Gjatë kohës së menstruacionit dhëndërit i janë të lejuara të gjitha çështjet përpos marrëdhënieve intime.

Muhamedi a.s. në hadithë thotë:

"Është e lejuar gjithçka përpos marrëdhënieve intime".

Zoti i Madhëruar në Kur'anin Fisnik thotë:

وَيَسْأَلُونَكَ عَنِ الْمَحِيضِ قُلْ هُوَ أَذَىٰ فَأَعْتَزِلُوا النِّسَاءَ فِي الْمَحِيضِ وَلَا تَقْرَبُوهُنَّ حَتَّىٰ يَطْهَرْنَ فَإِذَا تَطَهَّرْنَ فَأْتُوهُنَّ مِنْ حَيْثُ أَمَرَكُمُ اللَّهُ ...


"Të pyesin ty (o Muhamed) për menstruacionin. Thuaj: Ajo është gjendje e neveritur, andaj largohuni dhe mos iu afrohuni (mos bëni marrëdhënie intime) derisa të pastrohen. E kur të pastrohen, atëherë afrohuni atyre (dhe kontaktoni intimisht) ashtu siç u ka lejuar Allahu ...".


(EL-BEKARE, 222)

Perioda e pastërtisë në mes dy cikleve menstruale duhet të jetë bile pesëmbëdhjetë ditë.

Ai i cili kryen haxhin "TEMETUE", pas kryerjes së Umres, ka të drejtë martese e po ashtu edhe të drejtë marrëdhënie seksuale deri në ditën e 8 të Dhul Haxhes. Pas Umres lirohet nga ihrami, e si të lirohet haxhiu, ka të drejtë veshjen e rrobave, parfymosjen por edhe marrëdhëniet bashkëshortore, ndërsa kur të fillojë prap ihramin e Haxhit, në ditën e 8 të Dhul , ndalohet marrëdhëna bashkëshortore, deri sa ta kryejë Haxhin dhe deri sa të lirohet nga ihrami. Ndërkaq ai i cili nuk është në haxh, i lejohet marrëdhënia bashkëshortore në ditën e Bajramit ashtu siç lejohet edhe martesa në ditën e Bajramit. Ndërsa thëniyet se nuk ka fat martesa në ditën e Bajramit janë mendime, të cilat nuk kanë bazë islame.

Jo vetëm kjo, por te ne ka qenë traditë që në mes të dy Bajrameve, pra prej ditës së fitër Bajramit dhe deri në ditën e Kurban Bajramit (përafërsisht dy muaj e dhjetë ditë) të mos bëhen martesa. Edhe kjo nuk ka bazë, sepse të gjitha ditët e Allahut janë të njëjta. Disa kanë menduar se në muajin





Muharrem është e ndaluar martesë. Edhe kjo nuk ka kurrfarë baze islame.

Në një hadithë, të cilin e transmeton Muslimi, Nesaiu dhe Ahmed, Ajjshja r.a. ka thënë:

"Është martuar Muhamedi a.s. me mua në muajin Sheval. Mirëpo Muhamedi a.s. është martuar edhe në muajt tjerë dhe nuk ka paraparë ndonjë muaj të posaçëm".

Nuk ka argumente të sigurta se vaxhib është që martesë të bëhet të enjten në mbrëmje, gjegjësisht natën e xhumasë.





PASI TË CAKTOHET DITA E MARTESËS, NË DITËN E MARTESËS BËJNË BASHKËSHORTËT TEVBE DHE ISTIGFARE

Se çfarë vlere dhe rëndësie ka martesë në islam tregon hadithi i Muhamedit a.s. ku thotë:

"Kur të martohet njeriu, ai veç e ka plotësuar gjysmën e fesë së tij, le t'i frikësohet Allahut dhe le të kujdeset për pjesën tjetër".

EHREXHEHU

BEJHEKIU

Pasi që dhëndëri dhe nusja hynë në një fazë të re të jetës ata pendohen dhe kërkojnë falje për fazën e kaluar të jetës së tyre.

FESTA (GOSTIA) E MARTESËS

Festa e martesës mund të bëhet në shtëpi, por mund të bëhet edhe në vende të tjera (restorant, hotel) me kusht që aty të mos përdoret alkooli, ushqimi i ndaluar si mish i derrit, të mos jenë së bashku dhe të përzier femrat dhe meshkujt. Këto çështje janë të ndaluara edhe në jetë, pra në ditë të rëndomta të jetës e mos të flasim për ditën më të rëndësishme të jetës, pra ditën e martesës, sepse në këtë ditë fillon faza më e rëndësishme e jetës, pra krijimi i familjes. E si mund të pritët jetë e lumtur familjare dhe jetë e bekuar kur ajo fillon me sende të ndaluara!??

Islami rekomandon që me rastin e martesës të organizohet ndonjë gazmend e gosti, ku ftohen miqtë, dashamirët, shokët e të afërmit. Kur është martuar njëri prej shokëve të Muhamedit a.s. Muhamedi a.s.ka thënë:

"Organizo gosti, therre së paku (dhe përgatit ushqim) një dele".

Festa e martesës është sunet dhe këshillë e Muhamedit a.s., ku gostiten familjarët, të afërmit dhe dashamirët, pa marrë



parasysh a janë të varfër apo të pasur, por ftohen të ndershmit e të devotshmit. Muhamedi a.s. në hadithë ka thënë:

"Ushqimi më i keq i gostisë është ushqimi në të cilin ftohen të pasurit e nuk ftohen të varfërit".

MUTEFIKUN ALEJHI

Tregon Enes bin Maliku se:

"I dërguari i Allahut nuk ka bërë gosti më të madhe se ajo që bëri kur u martua me Zejneben. Më dërgoi t'i ftojta njerëzit, të cilëve u shtroi bukë dhe mish deri sa u ngopën".

BUHARIU

Përpos gostisë, është mirë që dasma të ketë gëzim dhe hare, të ketë biseda e kuvendime, me një fjalë dasma mos të jetë e padëgjuar, por të dëgjohet në familje, tek fqinjët, te shoqëria, sepse Muhamedi a.s. ka thënë:

"Martesën bëne sa më të përhapur sa më proklamative, përdoreni edhe defin".

Transmeton Ibn Maxhe nga Ajshja r.a. se:

"...femra nga Temimet është martuar me një burrë nga Ensarët, ndërsa Ajshja r.a. ka qenë ajo e cila e ka përcjellur nusen. Mirëpo pasi është kthye më herët te Muhamedi a.s. Muhamedi a.s. i ka pyeurt: Çka keni thënë oj Ajshe? U përgjegj: E kemi përcjellur dhe kemi bërë dua që të bekohet martesja dhe jemi kthyer. Muhamedi a.s. u ka thënë: Ensarët janë fis të cilëve u pëlqejnë shumë këngët".

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَدْخُلُوا بُيُوتَ النَّبِيِّ إِلَّا أَنْ يُؤْذَنَ لَكُمْ إِلَىٰ

طَعَامٍ غَيْرَ نَاطِرِينَ إِنَاهُ وَلَكِنْ إِذَا دُعِيتُمْ فَادْخُلُوا ...

"O ju që besuat, mos hyni në shtëpitë e pejgamberit ndryshe vetëm nëse ju lejohet për ndonjë ngrënie e duke mos pritur përgatitjen e saj, por kur të thirreni (përgjigjiuni ftesës) atëherë shkoni dhe hyni".

(AHZAB, 53)





Transmetohet nga Ibn Umeri r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë:

"Nëse ju fton dikush në gosti, shkoni dhe përgjigjuni ftesës së tij".

(MUTEFIKUN ALEJHI)

Duaja e të ftuarve në dasmë.

Transmetohet nga Ebi Hurejre r.a. se i dërguari s.a.v.s. i thoshte atij që martoej:

"BAREKE ALLAHU VE BAREKE ALEJKE VE XHEMEA BEJNEKUMA FIL HAJRIN".

(Ahrexhehu Imam Ahmed ve Termidhiu dhe Ibn Maxhe e të tjerë)

"Zoti të bekoftë ty dhe çka është me ty dhe ju bashkoftë gjithmonë në të mirë".


Tek ne, në disa vende, kur të bëhet teslimi bëhet nga baba, daja apo mixha, i cili me këtë rast i thotë babës së dhëndërit: *"Ja pafsh hajrin, ërëzi është i imi, namazi është i yti. Gjaku im, robi yt"*, kurse ky ia kthen: *"Qofsh faqebardh, o mik"*.

Teslimi (dorëzimi) më së miri është t'i bëhet drejtpërsëdrejti dhëndërit dhe drejtpërsëdrejti prej babës së nuses, i cili duhet t'i thotë:

"E martova bijën time N.N. (Filanen) për ty". Ose nëse dorëzimi i bëhet babës së dhëndërit i thuhet:

"E martova bijen time N.N. (Filanen) për djalin tënd N.N. (Filanin) Zoti i bekoftë ato dhe çka ka në mes tyre dhe i bashkoftë gjithmonë me të mirë".

Edhe pse duaja është e pëlqyeshme, fjala **"E martova"**, **"Ta dhashë vajzën"** ky tekst apo ky formulim i tekstit (SIGA) në sheriatin islam është farz në momentin e martesës. Sepse rukn (themel) dhe bazë e martesës është SIGA apo teksti i martesës, sikurse është sexhdeja RUKN në namaz. Ky tekst apo ky formulim ka mund të bëhet edhe në ditën e dërgimit të rrobave (petkave) kur është bërë edhe akti i kurorëzimit i dy të fejuarëve, kur është bërë shpallja e Nikahit (Martesës) në praninë e dëshmitarëve.



Fjalën "E martova për ty" e ka përdorur Zoti i Madhëruar në Kur'an "**Martoni**". E këtë fjalë e përdorim edhe në momentin e TESLIMIT apo dorëzimit të dorës së vajzës.

Në këtë ditë, por edhe në mbrëmje, edhe dhëndëri, edhe nusja e bëjnë këtë dua:

... رَبَّنَا هَبْ لَنَا مِنْ أَزْوَاجِنَا وَذُرِّيَّاتِنَا قُرَّةَ أَعْيُنٍ

وَاجْعَلْنَا لِلْمُتَّقِينَ إِمَامًا

"O Zoti ynë na dhuro bashkëshort (bashkëshorte) dhe pasardhës të cilët na bëjnë të lumtur, na gëzojnë, na qetësojnë trupin dhe shpirtin dhe na pushojnë sytë në ta".

(EL-FURKANË, 74)





NATA E MARTESËS

Natën e dhëndërisë, edhe dhëndëri, edhe nusja kur, të hynë në shtëpi, le të hynë me këmbën e djathtë dhe le të bëjnë këtë dua:

BISMILAH

ALLAHUME IN-NI ES'ELUKE HAJREL MEVLIXHI

VE HAJREL MAHREXHI

BISMILAH VELEXHNA

VE BISMILAH HAREXHNA

VE ALELLAH RABENA TEVEKELNA

(Ahrexhehu Ebu Davudë)

ME EMRIN E ALLAHUT

O ZOTI IM PREJ TEJE KËRKOJ HYRJE DHE

QËNDRIM TË DOBISHËM

E KUR TË DALË TË DALË I GËZUAR DHE ME TË

MIRA

ME EMRIN E ALLAHUT DO TË HYMË

ME EMRIN E ALLAHUT DO TË DALIM

DHE VETËM ALLAHUT, ZOTIT TONË I


MBËSHTEMI

(EBU DAVUDI)

Tek, ne kur të hyjë dhëndëri, atij i mëshojnë me grushta në shpinë dhe e shqelmojnë me qëllim që mos të hutohet kur të hyjë dhëndëri, dhe mos t'i harrojë prindërit e tij. Kjo nuk ka kurrëfarë baze dhe nuk lejohet të veprohet ashtu, por të bëhet dua ja siç na ka mësuar i dërguari i Allahut s.a.v.s. me rastin e hyrjes në dhomë apo në shtëpi të cilën e thamë më lart.

Tek ne një djalë i vogël e shtron shtratin dhe rrokulliset nëpër shtrat. Me këtë veprim dëshirohet që në atë shtrat të lindin vetëm djemë. Kjo gjithsesi duhet të hiqet e të bëhet dua ja si vijon:





... رَبَّنَا هَبْ لَنَا مِنْ أَزْوَاجِنَا وَذُرِّيَّاتِنَا قُرَّةَ أَعْيُنٍ

وَاجْعَلْنَا لِلْمُتَّقِينَ إِمَامًا

"O Zoti ynë na dhuro bashkëshortë (bashkëshorte) dhe pasardhës të cilët na bëjnë të lumtur, na gëzojnë, na qetësojnë trupin dhe shpirtin dhe na pushojnë sytë në ta". (EL-FURKANË, 74)

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

لِلَّهِ مُلْكُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ يَهَبُ لِمَنْ يَشَاءُ إِنَاثًا وَيَهَبُ لِمَنْ يَشَاءُ الذُّكُورَ ﴿٥٠﴾ أَوْ يُزَوِّجُهُمْ ذُكْرَانًا وَإِنَاثًا وَيَجْعَلُ مَنْ يَشَاءُ عَقِيمًا إِنَّهُ عَلِيمٌ قَدِيرٌ

"Ai i falë vetëm femra atij që do, e i falë vetëm meshkuj atij që do. Ose u falë çift, meshkuj e femra, por atë që do e le pa fëmijë (steril), Ai është i Dijshëm, i Fuqishëm". (ESH-SHURA, 49-50)

Kuptohet, pas hyrjes në dhomë dhëndëri dhe nusja e përshëndesin njëri-tjetrin me selam.



PASTËRTIA ZBUKURIMI DHE STOLIA

Pastërtia dhe bukuria janë cilësi të cilat ndikojnë në zgjerimin e krahërorëve, në tërheqjen e zemrave, krijimin e simpatisë, afrimit dhe lumturisë.

Po ashtu, Zoti i madhëruar në Kur'an thotë:

قُلْ مَنْ حَرَّمَ زِينَةَ اللَّهِ الَّتِي أَخْرَجَ لِعِبَادِهِ وَالطَّيِّبَاتِ مِنَ الرِّزْقِ قُلْ هِيَ لِلَّذِينَ آمَنُوا فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا خَالِصَةٌ يَوْمَ الْقِيَامَةِ
كَذَلِكَ نَفْصَلُ الْآيَاتِ لِقَوْمٍ يَعْلَمُونَ

Thuaj: "Kush i ndaloi bukuritë dhe ushqimet e mira që Allahu i krijoi për robërit e vet? Thuaj: Ato janë në këtë botë për ata që besuan, e në ditën e kijametit janë të posaçme për ta. Kështu i sqarojmë argumentet një populli që kupton".

(EL EARAF, 32)

Po ashtu edhe Muhamedi a.s. i ka thënë Omerit r.a.:

"A dëshiron që të tregoj për çështjen më të mirë e cila mund ta disponojë njeriun? Ajo është gruaja e bekuar, e cila:

- Nëse e shikon burri, e bën të gëzuar dhe të lumtur;
- Nëse e urdhëron, e dëgjon;
- Nëse mungon, ia ruan nderin dhe pasurinë".


(PJESË E HADITHIT EHREXHEHU EBU DAVUDI)

Transmetohet nga Enes bin Maliku se ka thënë:

"Unë në jetën time nuk kam ndier aromë më të këndshme se aromën prej të dërguarit të Allahut s.a.v.s.".

(Pjesë nga hadithi të cilin e kanë transmetuar
BUHARIU DHE MUSLIMI)

Sikurse gratë që duhet të jenë të pastra dhe të zbukurohen për burrat e tyre, ashtu edhe burrat duhet të zbukurohen për gratë e tyre. Ib Abasi r.a. ka thënë: Vërtetë, unë dëshiroj të zbukurohem për gruan time, ashtu siç dëshiroj që edhe ajo të zbukurohet për mua.



Aroma është materje e tillë ajrore e cila përshkon trupin dhe dhuron iluzion të gërshetimit martesor të shpirtit dhe shqisave. Nuk është e rastit që aroma krijon veçori e cila është e përbashkët për shprehitë erotike dhe ceremonitë fetare. Aroma duhet të jetë mesatare, e jo e shumtë dhe e rëndë.





FALJA E DY REKATEVE

Muslimani dhe muslimanja gjithmonë duhet të jenë të pastër, gjithmonë duhet të fillojnë veprimet me emrin e Allahut, pra me Bismilah, gjithmonë t'i luten Allahut, t'iu mbështetë vetëm Atij, e sidomos për çastin më të rëndësishëm të jetës dhe fillimin e një faze të re të jetës. Për këtë arsye, pasi që kanë marrë abdest më herët, edhe dhëndëri, edhe nusja i falin nga dy rekate namaz ngjashëm me namazet tjera, a po më mirë me thënë si dy rekatet farz të sabahut. Pasi ta përfundojnë namazin (kuptohet veç e veç), secili prej tyre bënë këtë dua:

ALLAHUME BARIK LIJ FI EHLIJ

VE BARIK LI EHLIJ FIJH

VERZUKHUM MINNIJ

VERZUKNIJ MINHUM

THUME SHEËNUKE VE SHEËNU EHLLIKE

Duaja bëhet edhe vetëm në gjuhën shqipe

ZOTI IM MË BEKO ME BASHKËSHORTEN TIME

DHE BEKOJE ATË ME MUA

FURNIZOJE ATË ME MUA

DHE MË FURNIZO MUA ME ATE

Namazi është bekim i jetës, burim i rizkut dhe i lumturisë, eliminues i veprave të këqija. Nëse kjo natë fillon me namaz, namazi do të jetë dritë, furnizim dhe lumturi në jetë.





Kur të shikohet vetja në pasqyrë, mirë është të thuhet kjo dua:

ELHAMDULILAH
KEMA HASENTE HALKIJ
FE HASIN HULUKIJ
VE HARIM VEXHHIJ ALEN-NAR
ELHAMDULILAH
ELEDHI SEVA HALKI FE ADELEHU
VE KEREME SURETE VEXHHIJ
FE EHSENEHA
VE XHEALENIJ MINEL MUSLIMINË

Në gjuhën shqipe do të thotë:

*Të falenderoj o Zot
Ashtu si e ke përsosur trupin tim
Përsose moralin tim
Mbroje fytyrën time nga zjarri
Të falenderoj o Zot
Që e ke përsosur trupin tim në strukturim
Dhe e ke fisnikëruar fytyrën time
E ke zbukuruar
Dhe më ke bërë musliman*





KONTAKTI



Marrëdhënia seksuale është një nga shtyllat e martesës islame. Para fillimit të aktit të kontaktit martesor apo marrëdhënieve, edhe dhëndëri, edhe nusja e bëjnë këtë dua:

BISMILAH

ALLAHUME XHENIBNESH-SHEJTANE

VE XHENIBISH-SHEJTANE ALA MA REZEKTENA

(EHREXHEHU BUHARIU DHE MUSLIMI)

Që në gjuhën shqipe do të thotë:

O ZOTI IM! Largoje shejtanin prej nesh.

Po ashtu largoje shejtanin edhe prej foshnjes (nëse është caktuar të formohet prej këtij kontakti), me të cilën do të na furnizosh.

(FE INEHU IN JAKDIR BEJNEHUMA VELEDUN FI DHALIKE LEM JEDURRUHU SHEJTANU EBEDEN).

Tek ne, që nga kohët e lashta, ka qenë zakon që gjatë rrugës krushqit duhet ta thyejnë rrugën (ta ndryshojnë kahjen e shkuarjes) që nënkupton se dasma shkon mbarë dhe dreqi i cili pret në rrugë për të musuar diç për të martuarit me qëllim që më vonë t'iu sjellë të këqia në jetë, nga pritja e gjatë pëlçet si kokrra e kripës.

Poashtu, tek ne, kur niset nusja, dikush nga familja e vajzës e thërret dhëndërin me emër të rrejtshëm: "O N. N. hajde merre qikën" në mënyrë që dreqi (djalli) të mos kuptojë asgjë për bashkëshortët e rinj. Kështu, djalli duke pritur gjatë e pa sukses, pëlçet si kokrra e kripës.

Ky zakon duhet të hiqet sa më shpejt, sepse janë bestytini të lashta të cilat nuk kanë të bëjnë asgjë me islamit dhe janë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Kur'anin dhe hadithin, por duhet bërë duan të cilën na ka mësuar Muhamedi a.s.



BISMILAHİ ALLAHUME XHENIBNESH-SHEJTANE
VE XHENIBISH-SHEJTANE ALA MA REZEKTENA
(EHREXHEHU BUHARIU DHE MUSLIMI)

Që në gjuhën shqipe do të thotë:

O ZOTI IM! Largoje shejtanin prej nesh.

Po ashtu largoje shejtanin edhe prej foshnjës (nëse është caktuar të formohet prej këtij kontakti), me të cilën do të na furnizosh. (FE INEHU IN JAKDIR BEJNEHUMA VELEDUN FI DHALIKE LEM JEDURRUHU SHEJTANU EBEDEN).

Kjo dua duhet të bëhet gjithmonë, sepse **nëse fëmija fillon të formohet prej asaj nate, atë fëmijë e mbron Allahu nga shejtani.**

Me këtë lutje bëhet bashkimi i materjes me shpirtin, bashkimi i jetës me dhikrin (kujtimin) e Allahut.


Fjala ibadet apo adhurim ndaj Allahut është fjalë që ka kuptim shumë të gjërë në islam. Në islam çdo punë të cilën e bën njeriu për të fituar kënaqësinë e Allahut është ibadet për të cilën shpërblehet. Po ashtu, edhe çdo punë të cilën njeriu e ka për qëllim ta mbrojë veten prej haramit, është ibadet dhe shpërblehet. Në hadithin të cilin e transmeton Ebu Dherr el Gafari r.a. Muhamedi a.s. thotë:

"Edhe për kontaktin e juaj martesor keni shpërblim të sadakasë".

Shokët e kanë pyetur: O i dërguari i Allahut si mundet që ne duke plotësuar nevojën tonë për këtë të shpërblehemi? Muhamedi a.s. tha: Çka mendoni nëse ndonjëri bën kontakt jashtmartesorë, pra haram, a dënohet? Natyrisht se po!? Ja, kështu nëse bën kontakt martesor, pra të lejuar, shpërblehet".

Pasi që martesa islame është forma legale e kontaktit seksual, çdo njeri nga partnerët bashkëshortor duhet të shijojë ëmbëlsirën e mjaltes së njëri tjetrit.

Dashuria është ligj i jetës, i botës dhe i njeriut, dhe si të tillë duhet pranuar. Seksualiteti i plotësuar dhe dashuria e




realizuar janë mënyra të falenderimit të Zotit për të mirat me të cilat na shpërblen.

Është mirë që fjala t'i paraprijë aktit seksual. Nuk vlen gjë akti seksual i kryer në heshtje dhe vjedhurazi. Dashuria nuk duhet të jet shurdhmemece. Gjuha (fjala) është mjetë i butësisë dhe ajo i bënë ndjenjat ekuilibruese. Ai epshin e bënë të dyanshëm. Duke shprehur epshin, gjuha e bënë krejtësisht të përbashkët me atë që flet dhe atë që e dëgjon. Po ashtu, fjala bëhet këngë, muzikalitet, shikim i tingujve të pastër. Nëse erosi dhe logosi dëshirojnë barazi, kjo është për atë se paraqesin harmoni të trupit dhe shpirtit.

Puthja është gjë e shkëlqyeshme. Ekziston arti i të puthurit dhe shkalla e saj e notave. Së pari në faqe, pastaj në buzë, së fundi në gji, nxitja e të cilave do të shkaktojë fryerje emotive, pastaj të lëshohet më poshtë në stomak, deri në kënaqësi të plotë, gjuha me hajni vëhet në gropëzën e kërthizës, pastaj edhe në atë më intime. Është mjeshtri që senzualiteti i femrës të sillet deri në pikën e vlimit, e cila shpie në kënaqësi të përsosur. Nuk duhet hezituat duke kryer formalitetin më të imët i cili përmban nivelin e duhur të kënaqësisë së përgjithshme. Kënaqësia duhet të jetë e dyanshme, në mënyrë që të paraqesë kremtë të madhe të ndjenjave. Mashkulli, i cili është i mbërthyer vetëm me pasion, pos kënaqësisë së vërtetë, njëkohësisht është fatkeq i cili e derdh kot mashkullorin e vet.

Të aplikuarit e seksit është lojë zbavitje dhe kënaqësi (MULAABE). Është dhurata më e hareshme qiellore. Është një nga gjërat e mira (TAJIBAT) me të cilat Allahu e ka shpërblyer ekzistencën tonë. Kjo është kënaqësi, në të vërtetë shkalla më e lartë e kënaqësisë. Kjo është lumturi e vërtetë. Dhëndëri duhet të ketë parasysh që t'i afrohet dhe të kontaktojë me nusen ashtu si është më së miri dhe ashtu qysh është më e përshtatshme për të, dhe cila mënyrë është më joshëse, nga përpara, nga mbrapa (por në organin e përpamë jo në anus), në këmbë, ulur por



edhe në të gjitha format dhe mënyrat dhe në të gjitha mënyrat e përshtatshme dhe joshëse, por me kusht që të jetë në organin e përpamë të femrës, e kurrësesi në anus, sepse Muhamedi a.s. ka thënë:

"Mos kontaktoni me gratë në anusin (organin e prapmë) të tyre".

Po ashtu në një hadith tjetër Muhamedi a.s. ka thënë:

"Mallkuar është ai që kontakton në organin e prapëm, (në anus) të gruas".

Kur Zoti i madhëruar në Kur'an thotë:

... فَإِذَا تَطَهَّرْنَ فَأْتُوهُنَّ مِنْ حَيْثُ أَمَرَكُمُ اللَّهُ ...

"Kontaktoni me gratë ashtu siç ju ka urdhëruar Allahu".

(EL-BEKARE, 222)

Ka për qëllim organin seksual të përparëm. Në kur'anin fisnik në ajetin nr.223 të suretul Bekare, Zoti i lartëmadhëruar thotë:

... نَسَآؤُكُمْ حَرَّتْ لَكُمْ فَأْتُوا حَرَثَكُمْ أَنَّى شِئْتُمْ ...

"Gratë e juaja janë bashqe të juaja për ju, dhe ju (për ta mbjellë farën e juaj) në bashqet e juaja kontaktoni si të doni (dhe nga të doni)".

Ky ajet sqaron se gratë janë të krijuara për të lindë fëmijë ashtu siç tregon edhe hadithi i Muhamedit a.s. ku thotë:

"Martohuni me femra të dashura dhe që lindin".

Ndërsa mënyra e kontaktimit me ta është e lejuar në të gjitha format, në të gjitha mënyrat, dhe në të gjitha pozitat, me kusht që të kryhet hedhja e farës (spermës) në vaginë.


Muhamedi a.s. i ka thënë një shokut të tij Xhabirit r.a.:

"Po pse nuk e martove një të re dhe virgjëreshë, e cila të kishte zbavitur, kishte lozur me ty, të kishte dëfryer dhe të kishte bërë të lumtur, ndërsa edhe ti e kishte zbavitur, kishte lozur me të, e kishte dëfryer dhe e kishte bërë të lumtur".

(MUTEFIKUN ALEJHI)

Lejohet që bashkëshortët t'i shikojnë organet e njëri-tjetrit, sepse kjo shton aftësinë e dikujt për të arritur thelbin e





ekstazës. Po ashtu para marrëdhënieve lejohet ndonjë mahi e lehtë. Loja, zbavitja dhe dëfrimi luajnë rol të rëndësishëm në marrëdhënet bashkëshortore.

Muhamedi a.s. ka thënë:

"Asnjë nga ju mos të kontaktojë, sikurse e kryejnë kontaktin kafshët, por gjatë marrëdhënieve le të ketë "delegacion" (RESUL). Kur është pyetur i dërguari çka është delegaciono (RESUL), Muhamedi a.s. është përgjegj: "Puthja dhe bisedat e ndërsjellta".

(BEJHEKIU)

Transmetohet nga Enes bin Maliku se Muhamedi a.s. ka thënë:

"Kur ndokush prej jush kontakton intimisht me bashkëshortën e tij le të japë maksimumin e sadakasë. Kur ta kryejë vet aktin seksual para se femra ta përfundojë, mos ta hjeqë organin seksual para se bashkëshortja ta përfundojë nevojën e saj".

Imam Gazaliu në librin "IHJA ULUMUD-DINË" thotë:

"Kur burri ejakulon dhe e hedh spermën, le të pretë edhe një kohë deri sa edhe gruaja t'i lëshojë vezorët e saj, se mundet që asaj t'i vonohet ekstaza, dhe kjo ndikon që ajo të ndihet keq".

Pas kryerjes së marrëdhënieve fillojnë epshet dhe pasionet në mënyrë graduale të zvogëlohen. Gjatë kësaj kohe nusja dhe dhëndëri kalojnë në dashurinë shpirtërore, e cila mund të llogaritet edhe kënaqësia kulminante, sepse kënaqësia nuk përfundon me ngopjen e trupit, por e pason kënaqësia shpirtërore. Për këtë arsye edhe trupi ndien nevojë që edhe për një kohë të jetë në krahëror, respektivisht i mbështetur për trupin tjetër që të përjetojë butësinë, ledhatinë dhe dashurinë, me qëllim që edhe kur të bëhet ndarja fizike të mbetet afërsia dhe dashuria shpirtërore.





Zoti i Madhëruar në Kur'anin fisnik thotë:

وَمِنْ آيَاتِهِ أَنْ خَلَقَ لَكُمْ مِنْ أَنْفُسِكُمْ أَزْوَاجًا لِتَسْكُنُوا إِلَيْهَا وَجَعَلَ بَيْنَكُمْ

مَوَدَّةً وَرَحْمَةً إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ

"Dhe nga argumentet (e madhërisë) e Tij është që për të mirën tuaj Ai krijoi nga vet lloji i juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje e qetësi (trupore e shpirtërore) tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri e mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë".

(ERR-RRUME, 21)

Nuk është mirë që menjëherë pas marrëdhënies seksuale t'ia ktheni shpinën, t'i mbyllni sytë dhe tëbini në gjumë. Mos e lini bashkëshorten të vetmuar dhe si të lënë pas dore.

Është e pëlqyer (MUSTEHAB) që kur dëshironi t'i përsëritni marrëdhëniet të merrni abdest, mirëpo me këtë abdest nuk lejohet të faleni.

Transmeton Muslimi në Sahihun e tij hadithin nga Ebi Seid el Hudriu se Muhamedi a.s. ka thënë:

"Kur ndokush prej jush kontakton me gruan e tij dhe dëshiron t'i përsëritë, le të merr abdest".

Ky abdest quhet abdesti i kontaktit intim. Kjo ndihmon bashkëshortët për të rifreskuar fuqinë. Është e pëlqyer (MUSTEHAB) që kur bi të flesh, të flesh me abdest. Njësoj vepron edhe nusja.



GUSULI

Pastërtia është pjesë e besimit, ndërsa fëlliqësira dhe papastërtia janë vepër e shejtanit.



Gusuli është pastrim i tërësishëm i trupit me qëllim të largimit të papastërtisë së madhe (hadethul ekber), e cila pengon kryerjen e ibadeteve. Sikurse ka urdhëruar Allahu pastrimin e zemrës, ashtu ka urdhëruar edhe pastrimin e trupit, i cili pastrim pjesët e trupit i përforcon dhe e qetëson shpirtin. Një pjesë e madhe mendojnë se gusuli është hyrja në banjo dhe pastrimi me shampun dhe sapun. Kjo formë e pastrimit nuk është gusul, dhe personi i tillë vazhdon të mbetet ende i papastërt (xhunub) edhe nëse vepron në të njëjtën mënyrë tërë jetën. Për t'ë larguar papastërtinë (xhenabetin), patjetër duhet që me ujë plotësisht të pastërt të pastrohet tërë trupi dhe në të njëjtën kohë të pastroni edhe brendinë e hundës dhe brendinë e gojës deri në laring, e pas kësaj lejohet të përdoret sapuni, shampuni dhe çështjet tjera të pastrimit.

Pra farzet e gusulit janë:

1. Që **goja**, brendësia e gojës së bashku me fytin të pastrohen mirë.
2. **Hunda** dhe brendësia e hundës deri në asht të pastrohet mirë.
3. I tërë **trupi** të pastrohet.

Këto janë farzet e gusulit. Nëse njëra prej këtyre farzeve nuk plotësohet, atëherë gusuli është i papranuar. Mirëpo, tani do të tregojmë edhe sunetet dhe veprimet tjera të gusulit.

Në rend të parë bëhet nijeti, pastaj fillohet me "Bismilah", pastrohen duart, lahen pjesët e turpshme të trupit. Pastaj mirret abdesi njësoj sikurse abdesti për namaz, pastrohet koka, pastaj ana e djathtë e trupit, pastaj ana e majtë dhe kështu pastrohet trupi në tërësi. Vetëm një herë pastrimi i trupit është



farz, ndërsa dy herë tjera është sunet. Pas kësaj, apo pas plotësimit të farzeve, mund të përdoren llojet e шамponave, sapunëve, erërave etj.etj.

Gjatë gusulit nuk është mirë të luteni e të ktheheni në drejtim të kybles, sepse njeriu është lakuriq, e lakuriq nuk lejohet të bëni lutje.

Gjatë pastrimit apo gusulit bashkëshortët lejohet që t'i ndihmojnë njëri-tjetrit ose të lahen së bashku, ose dhe të lozin mes vete. Transmetohet nga Ajshja r.a. se ka thënë:

"Deri sa ishim xhunub (të papastër prej kontaktit seksual) jam pastruar me të dërguarin e Allahut s.a.v.s. dhe merrnim ujë prej një ene, ndërsa duart tona përziheshin dhe Muhamedi a.s. ishte më i shpejtë dhe e merrte gotën (ujin) para meje, e unë i thosha: lerma mua, lerma mua".

MUTEFIKUN ALEJHI

Martesa nuk është vetëm kënaqësi, por edhe obligim dhe përgjegjësi. Muhamedi a.s. në hadith thotë:

"Të gjithë ju jeni barinj dhe secili do të përgjigjet për kopenë e vet;

Udhëheqësi është burri dhe do të përgjigjet për kopenë e vet.

Burri është bari në familjen e vet dhe do të përgjigjet për familjen e vet.

Gruaja është bari në shtëpi të burrit të vet

Shërbëtori është bari në pasurinë e pronarit të vet

Njeriu është bari në pasurinë e babait të vet

Pra secili është bari dhe secili ka përgjegjësi për kopenë e vet".

BUHARIU DHE MUSLIMI





DUAJA PARA SE TË BINI TË FLENI

Para se të bini të fleni pasi që është marrë abdesti, mirë është të këndohet „KUL HUVALLAHU", "KUL EUDHU BI RABIL FELEKI" dhe "KUL EUDHU BI RABIN-NASI".

Tek ne, në disa vende, kur niset nusja, dikush nga familja e vajzës e thërret dhëndërin me emër të rrejshëm: "O N.N. Hajde merre qiken", në mënyrë që dreqi (djalli) të mos kuptojë asgjë për bashkshortët e rinj. Kështu djalli duke pritur gjatë e pa sukses, pëlcet si kokrra e kripës, çka është bestytни. Po ashtu edhe vjehrra i ruan tërë natën që mos t'i bëjë kush magji. Ndërsa në këtë libër po i përkthejmë domethënien e tri sureve të lartpërmendura e të kuptojmë se si na ka mësuar Muhamedi a.s. para se të biem të flemë.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ ۝ اللَّهُ الصَّمَدُ ۝ لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ ۝ وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ ۝

SUREJA IHLAS

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Thuaj: Ai, All-llahu është Një!

All-llahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë.

As s'ka lindur kë, as nuk është i lindur.

Dhe Atij askush nuk i është i barabartë.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ ۝ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ ۝ وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ ۝ وَمِنْ

شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ ۝ وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ ۝

SUREJA FELEK

Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Thuaj: I mbështetem Zotit të agimit,

Prej dëmit të çdo krijese, që Ai e krijoi.

Dhe prej errësirës së natës kur ngryset plotësisht.

Dhe prej dëmit të atyre që lidhin dhe fryjnë nyja.

Edhe prej dëmit të smirëkeqit kur sipas smirës vepron.



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ ﴿مَلِكِ النَّاسِ﴾ ﴿إِلَهِ النَّاسِ﴾ ﴿مَنْ شَرَّ الْوَسْوَاسِ
الْخَنَّاسِ﴾ الَّذِي يُوَسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ ﴿مِنَ الْجِنَّةِ وَ
النَّاسِ﴾

SUREJA NAS

Me emrin e All-Illahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Thuj: "Mbështetem (mbrohem) me Zotin e njerëzve!

Sunduesin e njerëzve,

Të adhruarin e njerëzve,

Prej të keqes së cytësit që fshihet.

I cili bën cytje në zemrat e njerëzve,

Qoftë ai (cytësi) nga xhinët ose nga njerëzit".

Po ashtu, është mirë të këndohet "AJETUL KURSIJA" dhe dy
ajetet e fundit të "SURETUL BEKARE" (AMENE RRESULU).

Pastaj të mbështeteni në krahun e djathtë dhe të thoni:

ALLAHUME INNI ESLEMTU NEFSIJ ILEJKE
VE VEXHEHTU VEXHHI ILEJKE
VE FEUDTU EMRI ILEJKE
VE ELXHEËTU DHAHRI ILEJKE
VE REGABTU VE REHEBTU MINKE
LA MELXHEE VE LA MUNXHIE IL-LA ILEJKE
ESTEGFIRUKE VE ETUBU ILEJKE
AMENTU BI KITABIKEL-LEDHI ENZELTE
VE BI NEBIJKE EL-LE DHI ERSELTE

Duaja bëhet edhe në gjuhën shqipe:

***"ZOTI IM t'u dorzova Ty, ta lashë shpirtin tim në dorën Tënde
E ktheva fytyrën time kah Ti***

Ty ta besova fatin tim

Fenë time e lashë në mbrojtjen Tënde

Të madhëroj Ty dhe të frikësohem Ty

***Unë nuk kam ku të fshehem prej Teje, por kërkoj strehim
tek Ti. Besoj në librin tënd të shpallur***

Dhe i besoj pejgamberit që e ke dërguar Ti".





DUAJA E ZGJIMIT NGA GJUMI

ELHAMDULILAH I LEDHI AFANIJ FI XHESEDI
VE REDE ALEJE RUHIJ
VE EDITINE LIJ DHIKRUHU

***"Të falenderoj o Zot që trupin tim e ke bërë të shëndoshë.
E ke kthyer prap shpirtin tim.
Dhe më bën që të të kujtoj".***

FALJA E NAMAZIT TË SABAHUT

Nata e dhëndërisë nuk është natë e veçantë, në të cilën nuk falet namazi i natës dhe namazi i sabahut, por përkundrazi është natë ku bashkëshortët e fillojnë ditën me namaz të sabahut. Natën ku fillojnë që prej asaj lidhje bashkëshortore t'i kryejnë edhe obligimet e Allahut e atë duke filluar me namazin e sabahut. Muhamedi a.s. thotë:

"Allahu e mëshiroftë njeriun i cili zgjohet natën, falet dhe e zgjon gruan e tij dhe ajo po ashtu falet, e nëse refuzon e stërpikë fytyrën e saj me ujë dhe e zgjon".

AHMEDI DHE EBU DAVUDI

"Allahu e mëshiroftë gruan e cila zgjohet natën, falet dhe e zgjon burrin e saj dhe ai po ashtu falet, e nëse e refuzon e stërpikë fytyrën e tij me ujë dhe e zgjon".

AHMEDI DHE EBU DAVUDI

Kuptohet pastaj falet namazi i sabahut. Zoti i madhëruar në Kur'an thotë:

وَأْمُرْ أَهْلَكَ بِالصَّلَاةِ وَاصْطَبِرْ عَلَيْهَا لَا نَسْأَلُكَ رِزْقًا نَحْنُ نَرْزُقُكَ

وَالْعَاقِبَةُ لِلتَّقْوَى

"Urdhëro familjen tënde të falë namaz, edhe bëhu i durueshëm (e edhe ti fal namaz), Ne të furnizojmë ty (dhe ata) e nuk kërkojmë prej teje ndonjë furnizim (për ty as për familjen tënde). Ardhmëria e mirë (dhe e lumtur) është për të devotshmit".

(TA HA, 132)





MBAJTJA E SEKRETEVE BASHKËSHORTORE

Çdo individ ka fshehtësi, çdo çift bashkëshortor ka fshehtësi, çdo familje ka fshehtësi. Kjo është natyrshmëri e jetës për t'i fshehur gabimet dhe të metat. Zbulimi i të metave sjell neveri dhe gabim pas gabimi. Zoti i madhëruar në kur'an thotë:

... فَالصَّالِحَاتُ قَانِتَاتٌ حَافِظَاتٌ لِّلْغَيْبِ بِمَا حَفِظَ اللَّهُ ...

" ... Ato mbajnë në vetvete çdo sekret të burrave të tyre ...".

(EN NISAE, 34)

Në Kur'an Zoti i madhëruar marrëdhëniet dhe raportet midis bashkëshortëve i ka krahasuar me atë të veshjes dhe trupit:


... هُنَّ لِبَاسٌ لَّكُمْ وَأَنْتُمْ لِبَاسٌ لَّهُنَّ ...

"Ata janë për ju si një mbulesë (veshje), edhe ju jeni si një mbulesë për to". (EL-BEKARE, 187)

Këto fjalë të Zotit tregojnë lidhjen e ngushtë midis bashkëshortëve, unitetin dhe barazinë e tyre. Burri dhe gruaja janë përshkruar që të dy si veshje e njëri-tjetrit, e jo njëri si veshje e tjetri si trup. Veshja është diçka që qëndron fare pranë trupit. Është ky intimiteti i raportit që ekziston midis bashkëshortëve të rinjë. Veshja e zbukuron atë që e vesh. Burri dhe gruaja plotësojnë njëri-tjetrin. Çdonjëri nga bashkëshortët plotëson, përsos dhe pasuron tjetrin.

Në një hadithë i dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:

"Çdonjerit prej umetit tim do t'i falen gabimet, përpos zbuluesit të sekreteve (Muxhahirine). Zbuluesi i sekreteve (Muxhahir) është kur burri kontakton me gruan e vet natën, pra në fshehtësi të plotë, ndërsa ai në mëngjes thotë: O filan mbrëmë kam vepruar (me bashkëshorten), ishte kështu e ashtu. Natën Zoti i Madhëruar e ka bërë që të jetë i fshehur,



ndërsa ai ditën zbulon fshehtësitë, të cilat Allahu i ka lënë të jenë të fshehta".

(BUHARIU DHE MUSLIM)

Po ashtu në një ajet tjetër Muhamedi a.s. thotë:

"Prej njerëzve më të këqinj te Allahu në ditën e kijametit është njeriu i cili ka kontaktuar me bashkëshorten e tij, edhe tjetri po ashtu, e pastaj i tregojnë njëri-tjetrit gjithë çka kanë bërë natën". (MUSLIMI)





IDE TI



Sqaruam më herët se ndarja e bashkëshortëve mund të ndodhë pas aktit të kurorëzimit dhe para të vetmuarit me bashkëshorten, në këtë rast burri e shkurorëzon bashkëshorten, mirëpo bashkëshortja që në momentin e thënies "**Je e shkurorëzuar**" ajo mund të shkojë në shtëpinë e saj dhe nuk prit ndonjë afat të caktuar (IDET) për martesë me ndokend tjetër dhe e merr gjysmën e mehrit.

Zoti i Madhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا نَكَحْتُمُ الْمُؤْمِنَاتِ ثُمَّ طَلَقْتُمُوهُنَّ مِنْ قَبْلِ أَنْ تَمْسُوهُنَّ فَمَا لَكُمْ عَلَيْهِنَّ مِنْ عِدَّةٍ تَعْتَدُونَهَا فَمَنْعُوهُنَّ وَسَرَخُوهُنَّ سَرَاحًا جَمِيلًا

"O ju që besuat, kur të keni lidhur kurorë me besimtaret e pastaj i lëshoni ato para se të keni kontaktuar me to, ju nuk keni të drejtë të kërkonit që ato të presin afatin e caktuar (iddetin), po jepni diçka atyre dhe lironi në mënyrë të njerëzishme". (AHZAB, 49)

Mirëpo ne sqaruam se nëse shkurorëzimi ndodh natën e dhëndërisë pas të vetmuarit dhe kontaktit intim, në këtë rast ndryshojnë rregullat. Me fjalë të tjera patjetër bashkeshorti dhe bashkëshortja duhet t'i përmbahen disa ligjeve, të cilat i ka caktuar Zoti i Madhëruar.

Ka raste ku mënjëherë pas natës së parë burri e lëshon (shkurorëzon) gruan dhe e shpie në shtëpi të saj. Kjo nuk lejohet në sheriatin islam, sepse prej natës së parë të dhëndërisë, kur vetmohet me nusën, që nga ai moment minimumi i qëndrimit të gruas në shtëpinë e burrit është tri kohëra të menstruacionit.

Kjo pritje e gruas në shtëpinë e burrit edhe pas shkurorëzimit në sheriatin islam quhet IDET.



Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

وَالْمُطَلَّاتُ يَتَرَبَّصْنَ بِأَنفُسِهِنَّ ثَلَاثَةَ قُرُوءٍ ...

"Të shkurorëzuarat le të presin afatin prej tri kohërave të menstruacionit". (BEKARE, 228)

Pra, IDET do të thotë numërim , pritje. Ndërsa në sheriatin islam IDET quhet koha e kufizuar me ligj, për t'i definuar dhe për t'i përfunduar çështjet të cilat rezultojnë prej shkakut dhe gjurmëve të martesës. IDETI në islam është VAXHIB që do të thotë detyrë e obliguar e jo sipas dëshirës.

IDETI ndryshon varësisht prej formës së ndarjes bashkëshortore dhe varësisht prej gjendjes së gruas.

Nëse burri e lëshon bashkëshorten, e shkurorëzon natën e parë, pasi të vetmohet, edhe pse nuk bën marrëdhënje intime, IDETI i gruas është tri kohëra të menstruacioneve-pastrimit (THELATHETE KURUË).

Zoti i Madhëruar thotë:

وَالْمُطَلَّاتُ يَتَرَبَّصْنَ بِأَنفُسِهِنَّ ثَلَاثَةَ قُرُوءٍ ...

"Gratë e shkurorëzuara patjetër duhet të presin afatin e kalimit të tri menstruacioneve".

(EL BEKARE, 228)

Nëse femra shkurorëzohet, dhe ajo nuk ka menstruacione, atëherë IDETI është i përcaktuar tre muaj të plotë të kalendarit hënor.


Zoti i Madhëruar në Kur'anin fisnik thotë:

وَاللَّائِي يَئْسَنَ مِنَ الْمَحِيضِ مِنْ نَسَائِكُمْ إِنْ ارْتَبْتُمْ فَعِدَّتُهُنَّ ثَلَاثَةُ أَشْهُرٍ

وَاللَّائِي لَمْ يَحِضْنَ وَأُولَاتُ الْأَحْمَالِ أَجَلُهُنَّ أَنْ يَضَعْنَ حَمْلَهُنَّ ...

"E ato gratë tuaja, të cilave u është ndërprerë cikli mujor (menstruacioni), nëse nuk e keni ditur, koha e pritjes së tyre është tre muaj të plotë, e ashtu edhe ato që ende nuk kanë pasur menstruacion ...". (TALAK, 4)





Nëse burri vdes natën e dhëndërisë, pas vetmimit me nusën ose pas marrëdhënieve intime, atëherë IDETI nuk është tri kohëra të menstruacioneve ose tre muaj të kalendarit hënor, por 4 muaj e dhjetë ditë.

Zoti i Madhëruar në Kur'anin fisnik thotë:

وَالَّذِينَ يَتُوفُونَ مِنْكُمْ وَيُذَرُونَ أَزْوَاجًا يَتَرَبَّصْنَ بِأَنْفُسِهِنَّ
أَرْبَعَةَ أَشْهُرٍ وَعَشْرًا

"E ata që vdesin dhe lënë gra pas vete, ato (gratë) presin katër muaj e dhjetë ditë". (EL-BEKARE, 234)

Nëse femra shkurorëzohet, mirëpo gjatë pritjes së IDETIT vdes burri, atëherë prej momentit të vdekjes ndërpritet IDETI i shkurorëzimit dhe fillon numërimi apo fillon IDETI tjetër, pra IDETI për shkak të vdekjes së burrit. E dihet se IDETI i gruas për burrin e vdekur është 4 muaj e dhjetë ditë.

Zoti i Madhëruar thotë:

وَالَّذِينَ يَتُوفُونَ مِنْكُمْ وَيُذَرُونَ أَزْوَاجًا يَتَرَبَّصْنَ بِأَنْفُسِهِنَّ
أَرْبَعَةَ أَشْهُرٍ وَعَشْرًا

"E ata që vdesin dhe lënë gra pas vete, ato (gratë) presin katër muaj e dhjetë ditë".

(EL BEKARE, 234)

Nëse gjatë IDETIT paraqitet shtatëzania e gruas apo fillimi i krijimit të embrionit, atëherë IDETI nuk është as tri kohëra të menstruacionit, e as tre muaj të kalendarit hënor, e as katër muaj e dhjetë ditë, por deri sa të lindë fëmija.



Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

... وَاللَّائِي لَمْ يَحِضْنَ وَأُولَاتُ الْأَحْمَالِ أَجَلُهُنَّ أَنْ يَضَعْنَ حَمْلَهُنَّ ...

"Ndërkaq, (nëse paraqitet shtatëzënia) për shtatzënat afati i pritjes së tyre është deri sa të lindin".

(TALAK, 4)





Në kohën e IDETIT rezultojnë çështje të caktuara e ato janë:

E para: Nuk ka të drejtë të fejojë, duke pasur parasysh se ende ka gjurmë të martesës, me fjalë të tjera disa detyra, të drejta dhe obligime martesore deri sa të përfundojë ai afat. Pa marrë parasysh IDETI është për shkak të shkurorëzimit apo për shkak të vdekjes së burrit.

Me rastin e shkurorëzimit është e ndaluar fejesa, edhe haptazi, edhe fshehtazi, sepse Zoti i Madhëruar nu Kur'an thotë:

لَا جُنَاحَ عَلَيْكُمْ فِيمَا عَرَّضْتُمْ بِهِ مِنْ خِطْبَةِ النِّسَاءِ أَوْ أَكْنَنْتُمْ فِي أَنْفُسِكُمْ...

"Nuk është mëkat për ju (atëherë kur gratë e shkurorëzuara e kanë kryer afatin e pritjes-IDETIN) t'iu paraqiteni për martesë grave në mënyrë të tërthortë, ose duke e mbajtur fsheht në veten tuaj"

(EL BEKARE, 235)

E deri te pjesa e ajetit Kur'anor:

... لَا تَوَاعِدُوهُنَّ سِرًّا إِلَّا أَنْ تَقُولُوا قَوْلًا مَعْرُوفًا ...

"Por kurrsesi mos u premtoni atyre fshehtazi (diç tjetër për fejesë apo martesë) përpos t'u thoni fjalë të lejuara".

(EL BEKARE, 235)

E dyta: Femra në IDET nuk ka të drejtë të bëjë aktin e kurorëzimit. Zoti i Madhëruar thotë:



... وَلَا تَعْرَمُوا عُقْدَةَ النِّكَاحِ حَتَّى يَبْلُغَ الْكِتَابُ أَجْلَهُ ...

"Dhe mos bëni akt kurorëzimi (me ndonjë burrë tjetër) deri sa të përfundojë afati i caktuar i (IDETIT)".

(EL BEKARE, 235)

Nëse bën akt kurorëzimi me ndonjë burrë tjetër gjatë IDETIT, akti i kurorëzimit është i pavlefshëm sikurse të kishte qenë e martuar, ndërsa me bashkëshortin e saj mund të bëjë aktë të kurorëzimit edhe gjatë IDETIT, sepse koha e pritjes së





femrës (IDETI) është i paraparë për ruajtjen e spermatozoidit, pra të pasardhësve të burrit. E kur të kalojë IDETI ka të drejtë të martohet me kë të dojë.

Gjat kësaj kohe (IDETIT) nëse burri dhe gruaja dëshirojnë të martohen ato mund të martohen pa dëshmitarë dhe pa akt të ri të kurorëzimit dhe pa mehr. Ndërsa prej momentit kur të kalojë IDETI, nëse burri dhe gruaja dëshirojnë të martohen, ato patjetër duhet të kenë dëshmitarë, të bëjnë akt të ri të kurorëzimit dhe të caktojnë shumë të re mehrit, e ajo të konsiderohet shumë e mehrit të caktuar.

E treta: Të ndaluarit e daljes nga shtëpia e burrit. Gjatë kohës së "IDETIT" gruaja nuk ka të drejtë të dalë nga shtëpia e burrit, sepse ende është pjesë e burrit, deri sa të kalojë "IDETI". Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ إِذَا طَلَّقْتُمُ النِّسَاءَ فَطَلِّقُوهُنَّ لِعِذَّتِهِنَّ وَأَحْصُوا الْعِدَّةَ وَاتَّقُوا

اللَّهَ رَبَّكُمْ لَا تُخْرِجُوهُنَّ مِنْ بُيُوتِهِنَّ وَلَا يَخْرُجْنَ


إِلَّا أَنْ يَأْتِيَنَّ بِفَاحِشَةٍ مُبَيَّنَةٍ ...

"O ti pejgamber (thua ju besimtarëve) kur t'i lëshoni gratë, lëshoni ato në IDETIN e tyre (afatin e pritjes së tyre) dhe numëroni mirë ditët e afatit të pritjes së tyre, e kinie frikë Allahun, Zotit tuaj, dhe mos i nxirrni ato prej shtëpisë (suaj) e cila tani është edhe e tyre, e edhe ato mos të dalin ndryshe, vetëm nëse bëjnë ndonjë imoralitet të qartë (dhe sillen në vendin për t'u ekzekutuar)".

(ET-TALAK, 1)

Ebu Hanife thotë se vet dalja është imoralitet.





E katërta: E drejta e detyruar për të qëndruar në shtëpinë e burrit dhe të furnizohet në shtëpinë e burrit dhe prej shtëpisë së burrit, pra burri financon për shpenzimet e saj.

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

... لَا تُخْرِجُوهُنَّ مِنْ بُيُوتِهِنَّ ...

"... dhe mos i nxirrni ato prej shtëpive të tyre ...".

(ET TALAK, 1)

Deri sa të skadojë afati i IDETIT, edhe pse gruaja është e shkurorëzuar, obligimin për ushqim dhe veshmbathje e ka burri dhe askush tjetër. Gjatë kësaj kohe, deri sa qëndron gruaja në shtëpinë e burrit, ajo nuk ka të drejtë të dalë nga shtëpia, andaj kujdesin për të e ka burri i cili e ka shkurorëzuar, sepse ajo e prit afatin për të shikuar formimin e embrionit, pra ende një pjesë e saj është e burrit, por edhe t'i lihet një afat që t'i rikthehen jetës bashkëshortore.

E pesta: Të mbajturit zi.

Të mbajturit zi nuk do të thotë të vishemi me tesha të zeza, por do të thotë mos të zbukurohemi, mos të stolisemi, mos të parfymosemi.

Femra mban zi tri ditë për vdekjen si psh. të babës, të nanën, të vëllait e tj. Ndërsa për burrin e saj mban zi katër muaj e dhjetë ditë. Në hadithin Sahihë Muhamedi a.s. thotë:

"Nuk lejohet për femrën muslimane, e cila beson në Zotin dhe në ditën e gjykimit, të mbajë zi më shumë se tri ditë përpos për burrin e saj katër muaj e dhjetë ditë".



E gjashta: E drejta e pasardhësit.

Nëse gjatë kohës së IDETIT mbetet gruaja shtatëzanë, atëherë ai fëmijë është fëmijë i burrit me të cilin është në IDET.

E shtata: E drejta e trashëgimisë.

Nëse ndonjëri prej bashkëshortëve vdes gjat kohës së IDETIT, atëherë ka të drejtë të trashëgojë ai i cili është gjallë,





pra nëse gruaja vdes, burri e trashëgon atë (nëse pronëson pasuri), por edhe nëse burri vdes gruaja e trashëgon atë.

Po e përsërisim edhe një herë se gruaja gjatë IDETIT konsiderohet grua në kuptimin e fjalës me të drejta të shariatit, andaj edhe ka të drejtë trashëgimie, ku Zoti i Madhëruar thotë:

وَلَكُمْ نِصْفُ مَا تَرَكَ أَزْوَاجُكُمْ إِنْ لَمْ يَكُنْ لَهُنَّ وَلَدٌ فَإِنْ كَانَ لَهُنَّ وَلَدٌ فَلَكُمْ

الرُّبْعُ مِمَّا تَرَكَنَ مِنْ بَعْدِ وَصِيَّةٍ يُوصِيْنَ بِهَا أَوْ دَيْنٍ

"Juve ju takon patjetër (si trashëgimi) gjysma e asaj (pasurie) që e lënë gratë tuaja, nëse ato nuk kanë fëmijë, por nëse ato kanë fëmijë, juve ju takon patjetër (trashëgimi) një e katërta nga ajo që e lënë ato".

(EN NISAE, 12)

Kjo është pjesa e ajetit ku Zoti i Madhëruar e ka caktuar obligim për të trashëguar burri nga gruaja, ndërsa gruaja në IDET ende është grua për burrin e saj.

Po ashtu Zoti i Madhëruar ka caktuar edhe pjesën e trashëgimisë së gruas ku thotë:

... وَلَهُنَّ الرُّبْعُ مِمَّا تَرَكَتُمْ إِنْ لَمْ يَكُنْ لَكُمْ وَلَدٌ فَإِنْ كَانَ لَكُمْ وَلَدٌ فَلَهُنَّ



النُّصْرُ مِمَّا تَرَكَتُمْ ...

"Atyre (grave) ju takon patjetër (trashëgimi) një e katërta nga ajo që lini ju, nëse nuk keni fëmijë, por nëse keni fëmijë, atyre ju takon patjetër (trashëgimi) një e teta nga ajo që e lini".

(EN NISAE, 12)

E teta: Numërimi (llogaritja) i shkurorëzimit.

Shkurorëzimi i natës së dhëndërisë numërohet shkurorëzim, dhe është shkurorëzim me të drejtë kthimi deri sa është e shkurorëzuar në IDET pa mehr, pa dëshmitarë dhe pa akt të ri, ndërsa pas IDETIT ka të drejtë të martohet me dëshmitarë, me akt të ri dhe me mëhër të ri.



Në shariatin islam burri nuk ka të drejtë të shkurorëzojë gruan më shumë se tri herë. Nëse herën e tretë e shkurorëzon, atëherë ajo grua është e ndaluar me ndalesë të përkohshme, që do të thotë se pas herës së tretë ajo vazhdon jetë të re, martesë të re dhe vetëm pas shkurorëzimit të asaj martese, ndërprehet ndalesa e përkohëshme dhe burri i parë ka të drejtë ta kërkojë, ta fejojë dhe ta martojë. Për këtë arsye theksuam se numërohet shkurorëzimi i parë.

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

الطَّلَاقُ مَرَّتَانٍ فَإِمْسَاكَ بِمَعْرُوفٍ أَوْ تَسْرِيحٍ بِإِحْسَانٍ ...

"Shkurorëzimi është dy herë, e pastaj burri ose ta vazhdojë (një herë e përgjithmonë) një jetë bashkëshortore të njerëzishme, ose një shkurorëzim me mirëkuptim".

(EL BEKARE, 229)

فَإِنْ طَلَّقَهَا فَلَا تَحِلُّ لَهُ مِنْ بَعْدُ حَتَّى تَتَّحِكَ زَوْجًا غَيْرَهُ فَإِنْ طَلَّقَهَا فَلَا

جُنَاحَ عَلَيْهِمَا أَنْ يَتَرَاجَعَا إِنْ ظَنَّا أَنْ يُقِيمَا حُدُودَ اللَّهِ ...

"E në qoftë se ai (burri) e shkurorëzon atë (për të tretën herë), nuk i lejohet ta martojë (ndalesë e përkohshme) deri sa të martohet ajo me një burrë tjetër. E nëse ai (burri i dytë) e shkurorëzon atë, atëherë (lejohet martesa) për ata të dy po që se mendojnë se kanë për t'i zbatuar dispozitat e Allahut, nuk ka pengesë të rikthehen (në bashkëshortësi)".

(EL BEKARE, 230)





ÇËSHTJET E PAPRITURA TË CILAT NDODHIN PREJ AKTIT TË KURORËZIMIT E DERI NË NATËN E DHËNDËRISË

- Është e ndaluar nëna e nuses për dhëndërin prej momentit kur e lidh aktin e kurorëzimit dhe vdes ajo nuse pa marr parasysh a është vetmuar në dhomë apo jo dhe pa marr parasysh se ka kryer marrëdhënie seksuale me të.

- Po ashtu është e ndaluar nëna e nuses për dhëndërin prej momentit kur e lidh aktin e kurorëzimit dhe e shkurorëzon pa marr parasysh a është vetmuar me nusen në dhomë apo jo, pa marr parasysh a ka kryer marrëdhënie seksuale me të. Kjo është e argumentuar me pjesën e ajetit kur'anor:

حُرِّمَتْ عَلَيْكُمْ ... وَأُمَّهَاتُ نِسَائِكُمْ ...

"U janë ndaluar juve.... dhe nënat e grave të juaja".

(NISA, 23)

Pra, ajeti nuk e ka përcaktuar ndalesën me kontakt seksual, por e ka përmend në mënyrë të përgjithshme, prandaj vetëm akti i kurorëzimit me femrën, bën që nana e saj të jetë e ndaluar për të, me ndalesë të përgjithmonshme.

Nëse martohet me nanën e një vajzës dhe e kryen aktin e kurorëzimit, mirëpo vdes, ose e shkurorëzon pa u vetmuar me të, lejohet martesë me vajzën e saj. Këtë e sqaron ajeti kur'anor:

حُرِّمَتْ عَلَيْكُمْ ...

وَرَبَائِبُكُمُ اللَّاتِي فِي حُجُورِكُم مِّن نِّسَائِكُمُ اللَّاتِي دَخَلْتُم بِهِنَّ فَإِن لَّمْ

تَكُونُوا دَخَلْتُم بِهِنَّ فَلَا جُنَاحَ عَلَيْكُمْ ...

"U janë ndaluar juve.... dhe vajzat që janë nën kujdesin tuaj e të lindura (prej tjetër babai) nga gratë tuaja me të cilat patët kontakt martesor, e nëse nuk keni pasur



kontakt me to (me gratë) atëher s'ka pengesë (të martoheni me ato vajza)". (NISA, 23)

Në këtë janë pajtuar të gjithë dijetarët. Është i njohur parimi te fukahatë: Akti i kurorëzimit me vajzat shkakton ndalesën e nënave të tyre. Ndërsa kontakti martesor me nënat ndalon vajzat e tyre (me burrë tjetër).

Nëse pas aktit të kurorëzimit ndodh deri te ndonjë mospajtim, apo burri e shkurorëzon pa u vetmuar, dhe pa kryer marrëdhënie intime, atëherë gruas nuk i takon mehri i plotë por i takon gjysma e mehrit. Këtë e potencon Zoti i Madhëruar në ajetin Kur'anor.

وَإِنْ طَلَّقْتُمُوهُنَّ مِنْ قَبْلِ أَنْ تَمْسُوهُنَّ وَقَدْ فَرَضْتُمْ لَهُنَّ فَرِيضَةً
فَنِصْفُ مَا فَرَضْتُمْ ...

"E nëse i lëshoni (shkurorëzoni) ato para se të kontaktoni, por u keni caktuar atyre një caktim (Mehrin e Kurorës), atëherë t'u jepni gjysmën e asaj që e keni caktuar..."

(EL BEKARE, 237)

Ndodh që akti i kurorëzimit është bërë, mirëpo gjatë aktit të kurorëzimit nuk është caktuar shuma e mehrit, atëherë gruas i takojnë rrobat dhe përgatitjet tjera që quhen METAË. Këtë e potencon Zoti i Madhëruar në ajetin Kur'anor:

لَا جُنَاحَ عَلَيْكُمْ إِنْ طَلَقْتُمُ النِّسَاءَ مَا لَمْ تَمْسُوهُنَّ أَوْ تَفْرِضُوا لَهُنَّ فَرِيضَةً
وَمَتَّعُوهُنَّ ...

"Nuk është mëkat për ju nëse i lëshoni (shkurorëzoni) gratë pa pasur kontakt martesor me to dhe para se t'u caktoni atyre ndonjë caktim (Mehrin), po pajisni ato (me pajisje METAË) ... "

(EL BEKARE, 236)





Natën e martesës është e mundur që dhëndëri të vdes pasi të vetmohet me nusen dhe para se të kryejë marrëdhënie seksuale, por edhe mund ta lëshojë (shkurorëzojë) pasi të vetmohet me nusen, por pa kryer marrëdhënie seksuale ose ta shkurorëzojë pas marrëdhënieve seksuale. Për të gjitha këto raste (për secilin rast) rezultojnë çështje të veçanta, sipas sheriatit islam, të cilat do t'i shpjegojmë një nga një.





VDEKJA E DHËNDËRIT PAS VETMIMIT ME NUSEN PA KRYER MARRËDHËNIE INTIME

Nëse dhëndëri dhe nusja vetmohen në dhomë, nuk kontaktojnë intimisht dhe aksidentalisht vdes dhëndëri, rezultojnë çështjet si vijon:

- Mbetet edhe më tutje virgjiniteti i vajzërisë (nëse ka qenë e pamartuar).
- Nuk është farz gusulli.
- TEHLILË. Nuk lejohet të martohet me bashkëshortin e saj të mëhershëm, i cili e ka shkurorëzuar tri herë, sepse nuk e ka përjetuar aktin seksual (asijletuhu)
 - I takon mehri i plotë, ose mehrul mithli (nëse ka qenë i papërcaktuar).
 - Duhet të pretë idetin (nuk ka të drejtë të martohet) para 4 muaj e dhjetë ditëve.
 - E drejta e trashëgimisë.
 - E drejta e mehrit. E nëse nuk ka qenë i caktuar atëherë, caktohet “Mehrul mithli”.





VDEKJA E DHËNDËRIT PAS MARRËDHËNIEVE INTIME

Nëse dhëndëri dhe nusja kryejnë marrëdhënie intime dhe aksidentalisht vdes dhëndëri, rezultojnë çështjet si vijon:

- obligohet gusulli;
- humbet virgjiniteti, që do të thotë se nëse pastaj bënë prostitucion dënohet me gurëzim (ekzekutim me vdekje) jo me 100 shkopinj;
- TEHLIL. Ka të drejtë të martohet me burrin e Mëhershëm, i cili e ka shkurorëzuar tri herë, sepse e ka përjetuar aktin seksual (asijletuhu);
- Duhet me pritë idetin (nuk ka të drejtë të martohet) para 4 muaj e dhjetë ditëve;
- E drejta e trashëgimisë;
- E drejta e mehrit.





SHKURORËZIMI I NUSES NATËN E DHËNDËRISË PAS VETMIMIT DHE PA KRYER MARRËDHËNIE INTIME

Nëse dhëndëri dhe nusja vetmohen në dhomë dhe burri e shkurorëzon nusën pa kryer marrëdhënie intime ,rezultojnë çështjet si vijon:

1. Nuk obligohet gusuli;
2. Nuk humbet virginiteti, që do të thotë se nëse pastaj bën prostitucion, dënohet me shkopinj jo me gurëzim.
3. TEHLILE - Nuk ka të drejtë të martohet me burrin e mëhershëm, i cili e ka shkurorëzuar tri herë, sepse nuk e ka përjetuar aktin seksual (asijletuhu);
4. Ka të drejtë të martohet me vajzën e asaj nuse (nëse ka genë e martuar dhe ka pasur vajzë), ndërsa nuk ka të drejtë të martohet me motrën e saj gjat idetit;
5. Nuk konsiderohet shkurorëzim me të drejtë kthimi (TALAK REXHIJ), që do të thotë se nëse dëshiron të martohet, duhet oferta dhe kërkesa, akti i ri, dëshmitarët, dhe mehri i ri ,nuk kanë të drejtë trashëgimie;
6. Nëse ndonjëri prej bashkëshortëve në kohën e idetit vdes, pra para tri kohëve të pastrimit, nuk kanë të drejtë trashëgimie;
7. Duhet të pretë idetin (tri cikle të pastrimit);
8. E drejta e mehrit.



SHKURORËZIMI I NUSES PAS MARRËDHËNIEVE INTIME



Nëse dhëndëri dhe nusja kryejnë marrëdhënie intime dhe e shkurorëzon pas marrëdhënieve intime ,rezultojnë çështjet të cilat vijnë:

1. Obligohet gusuli;
2. Humbet virgjiniteti, që do të thotë: nëse pastaj bën prostitucion dënohet me gurëzim (vdekje) jo me shkopinj;
3. Nuk ka të drejtë të martohet kurrë me vajzën e saj (sepse bëhet ndalesë e përgjithshme) dhe nuk ka të drejtë të martohet me motrën e saj deri sa ajo është në idet (afati i pritjes-tri cikle pastrimi), ndërsa pas tri cikleve të pastrimit ka të drejtë të martohet me motrën e saj;
4. TEHLILE.-Ka të drejtë të martohet me burrin e mëhershëm, i cili e ka shkurorëzuar tri herë, sepse e ka përjetuar aktin seksual (asijletuhu);
5. Konsiderohet shkurorëzim me të drejtë kthimi (Talak Rexhij), që do të thotë deri në kalimin e idetit (tri kohëra të pastrimit), ka të drejtë të martohet pa akt të ri, pa dëshmitarë dhe pa mehr të ri. Prej momentit të shkurorëzimit patjetër nusja duhet të qëndrojë në shtëpinë e burrit (dhëndërit) deri sa të kalojë IDETI, e ajo kohë është tre menstruacione (përafërsisht tre muaj). Gjatë kësaj kohe kujdesin për ushqim dhe veshmbathje e ka dhëndëri prej shpenzimeve të tij;
6. E drejta e trashëgimisë: Nëse ndonjëri prej bashkëshortëve vdes gjatë kohës së idetit të gruas (tri kohëra të pastrimit), ka të drejtë trashëgimie (1/8 nëse ka pasë ndonjëri fëmijë me grua tjetër, ose 1/4 nëse nuk kanë fëmijë);
7. E drejta e mehrit.



POROSI DHËNDËRIT DHE NUSES

Edhe dhëndëri edhe nusja, pasi që fillojnë një jetë të re, duhet që përpos të drejtave, detyrave dhe obligimeve të përbashkëta, të cilat i kanë, të porositen që:

1. Të mbrohet fort beslidhja bashkëshortore, sepse besëlidhja bashkëshortore është besëlidhje, të cilën e ka paraparë libri i Allahut dhe suneti i të dërguarit s.a.v.s.;

2. Të praktikojnë ligjet dhe rregullat e sheriatit islam, këshillim të ndërsjelltë, bekim të ndërsjelltë, mëshirë, dashuri dhe fitimin e xhenetit;

3. Të pendohen vazhdimisht, të kryejnë vepra të mira me qëllim të pastrimit të zemrave, qetësisë së shpirtit dhe ngritjes së edukatës dhe moralit;

4. Të ushqehen me ushqim të hallallit;

5. T'i ruajnë sekretet bashkëshortore;

6. T'i respektojnë dhe t'i nderojnë prindërit;

7. T'i forcojnë lidhjet familjare;

8. T'i kryejnë obligimet sipas prioriteteve, në rend të parë obligimet ndaj Allahut, pastaj ndaj familjes dhe fëmijëve, punës dhe prindërve;

9. Thirrja në fenë islame, sepse ajo është obligim i sheriatit dhe nevojë e njeriut;

10. Bindje e thellë se rriskun e ka caktuar Allahu dhe po ashtu edhe jeta edhe vdekja janë në caktimin e Allahut.



Po e përfundojmë këtë punim me premtimin e Zotit të madhëruar ku thotë:

Zoti ka përgatitur shpërblim të madh:

إِنَّ الْمُسْلِمِينَ وَالْمُسْلِمَاتِ وَالْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ وَالْقَانِتِينَ وَالْقَانِتَاتِ
وَالصَّادِقِينَ وَالصَّادِقَاتِ وَالصَّابِرِينَ وَالصَّابِرَاتِ وَالْخَاشِعِينَ وَالْخَاشِعَاتِ
وَالْمُتَصَدِّقِينَ وَالْمُتَصَدِّقَاتِ وَالصَّائِمِينَ وَالصَّائِمَاتِ وَالْحَافِظِينَ فُرُوجَهُمْ
وَالْحَافِظَاتِ وَالذَّاكِرِينَ اللَّهَ كَثِيرًا وَالذَّاكِرَاتِ أَعَدَّ اللَّهُ لَهُمْ مَغْفِرَةً وَأَجْرًا

عَظِيمًا

"Për burrat që praktikojnë
islamin

Për burrat që besojnë

Për burrat e bindur (në
urdhërat e Zotit)

Për burrat që i përmbahen
rrugës së drejtë

Për burrat që e japin
zekatin

Për burrat që agjërojnë

Për burrat që ruajnë veten
e tyre

Për burrat që kujtojnë
Allahun

dhe për gratë që
praktikojnë islamin.

dhe gratë që besojnë

dhe për gratë e bindura (në
urdhërat e Zotit)

dhe për gratë që i
përmbahen rrugës së drejtë

dhe për gratë që japin
zekatin

dhe për gratë që agjërojnë

dhe për gratë që ruajnë
veten e tyre

dhe për gratë që kujtojnë
Allahun.


Allahu ka përgatitur falje (mëkatesh)
dhe shpërblim të madh". (EL-AHZAB, 35)


E këto shpërblime dhurohen kur Zoti i Madhëruar thotë:

ادْخُلُوا الْجَنَّةَ أَنْتُمْ وَأَزْوَاجُكُمْ تُحْبَرُونَ

"Hyni në xhenet, ju dhe gratë tuaja, të gëzuar"

(EL-ZUHRUF, 70)





Fatlum është ai burrë i cili martohet me një grua që i përmbahet rregullave të fesë islame dhe dispozitave të sheriatit, i cili harmonizon jetën me të dhe, për të fituar botën tjetër, i përmbahet rregullave të fesë islame dhe dispozitave të sheriatit dhe fiton kënaqësinë e kësaj bote dhe të botës tjetër dhe bëhet besimtar i sinqertë.

Fatlume është ajo grua që ka fatin të martohet me një burrë që i përmbahet rregullave të fesë islame dhe dispozitave të sheriatit, ndërsa ajo përpiqet të mos e humbë bashkëshortin e vet, i përshtatet atij, e harmonizon jetën me të, e cila, për të fituar botën tjetër, i përmbahet rregullave të fesë islame dhe dispozitave të sheriatit dhe fiton kënaqësitë e kësaj bote dhe të botës tjetër duke u bërë si grua shembullore dhe besimtare e sinqertë.

Fatkeq është ai burrë që është martuar me një grua, e cila nuk i përmbahet rregullave të fesë dhe dispozitave të sheriatit dhe e len gruan e vet në rrugën e mëkateve e nuk përpiqet fare që ta pengojë atë nga ajo rrugë.

Fatkeqe është ajo grua që është martuar me një burrë, i cili nuk i përmbahet rregullave të fesë dhe dispozitave të sheriatit, ndërsa burri i vet e stimulon me ligësitë e rrugës së mëkateve.

Mjerë për ato çifte që me njëri-tjetrin bashkëveprojnë për të hyrë në thellësinë e zjarrit, duke u përpjekur që të zhyten thellë e më thellë në greminën e mëkateve.





PËRFUNDIMI



Është shumë vështirë të sqarohen në ligjerata shumë çështje të kësaj natyre, edhe në xhami ku prezantojnë fëmijët, të rinjtë dhe të vjetrit, e sidomos në vende ku prezantojnë gra të reja, e të vjetra. Mirëpo nuk duhet lënë në tërësi anash këto çështje të cilat janë pjesë e jetës dhe pjesë e ibadetit. Janë natyrshmëri e njeriut, themel i njeriut dhe element i vetëm i zhvillimit të llojit të njeriut.

Nëna e muslimanëve Ajshja r.a. ka thënë se gratë e ensarëve, kur ka qenë në pyetje mësimi i fesë, nuk janë turpëruar të pyesin. Ata kanë pyetur për çështjet e menstruacionit, lehonisë, për papastërtinë, për marrëdhëniet bashkëshortore, guslit etj.etj.

Në mësimet e kësaj natyre janë rregullat e pastërtisë, abdestit, menstruacionit, lehonisë e të ngjashme. Në rregullat e abdestit mësohet për prishjen e abdestit, çka del prej dy organeve prekja e organit mashkullor, prekja e femrës me epsh dhe pa te.

Sa i përket gusulit se kontakti seksual obligon gusulin, ejakulimi, menstruacioni që të gjitha kanë të bëjnë me seksualitetin.

E njejtë është edhe në shkencën e tefsirit dhe hadithit ku dijetarët nuk kanë kursyer asgjë që t'i përshkruajnë këto çështje, duke sqaruar ajetet e Allahut. Andaj, ky studim i thjeshtë është një tentim që së paku në të shkruar të sqarohen disa çështje të natyrës së marrëdhënieve intime në natën e dhëndërisë dhe rregullave të asaj nate, e po ashtu edhe çështjet të cilat rezultojnë prej asaj nate.



LIBRAT E AUTORIT

1. Besimi në Zotin
2. Melaqet e Zotit
3. Besimi në Librat e Zotit
4. Pejgamberët e Zotit
5. Besimi në Ditën e Kijametit
6. Besimi në Kaderin e Zotit
7. Tregime nga jeta e Muhamedit a.s.
8. Fikhu i Namazit
9. Fikhu i Zekatit
10. Fikhu i Agjërimit
11. Fikhu i Haxhit
12. Emërtoni fëmijët tuaj me emra të bukur
13. Dëshmorët e 9 Prillit në Rakoc dhe Lagje të Re
14. Shkruaj, lexo dhe mëso shkronjat e Kur'anit
15. Nata e Dhëndërisë

PËRKTHIMET NGA GJUHA ARABE

1. Këshilltari Fisnik për djem dhe vajza *(nga autori Muhamed Sajim)*
2. Islami dhe Politika *(nga autori Jusuf Kardavi)*
3. Mrekullitë Numerike në Kur'anin Fisnik *(nga autori Abdurrezak Nufel)*





PËRMBAJTJA:

Në vend të parathënies	4
Akti i kurorëzimit	9
Të ngatërruarit e aktit të kurorëzimit me aktin e fejesës	12
Caktimi i ditës së martesës	15
Pasi të caktohet dita e martesës, në ditën e martesës bëjnë bashkëshortët tevbe dhe istigfare	20
Festa (gostia) e martesës	20
Nata e martesës	24
Pastërtia zbukurimi dhe stolia	26
Falja e dy rekateve	28
Kontakti	30
Gusuli	36
Duaja para se të bini të fleni	38
Duaja e zgjimit nga gjumi	40
Falja e namazit të sabahut	40
Mbajtja e sekreteve bashkëshortore	41
Ideti	43
Çështjet e papritura të cilat ndodhin prej aktit të kurorëzimit e deri në natën e dhëndërisë	51
Vdekja e dhëndërit pas vetmimit me nusen pa kryer marrëdhënie intime	54
Vdekja e dhëndërit pas marrëdhënieve intime	55
Shkurorëzimi i nuses natën e dhëndërisë pas vetmimit dhe pa kryer marrëdhënie intime	56
Shkurorëzimi i nuses pas marrëdhënieve intime	57
Porosi dhëndërit dhe nuses	58
Përfundimi	61
Librat e autorit	62
Përmbajtja	63

